



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL DEÇAN

2023 – 2026

Deçan, Qershor 2023

PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL (2023-2026) DEÇAN

- ***Çfarë është PVRL-ja ?***

Plani i Veprimit i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal Deçan nënkupton politikën lokale për rini për vitin 2023/2026. Kjo është strategji gjithëpërfshirëse për të rinjtë e Deçanit duke u bazuar në nevojat dhe pjesëmarrjen e të rinjve .

- ***Me çfarë ka të bëjë?***

Ka të bëjë me veprim, pjesëmarrje, arsimim, punësim, shëndetësi, ka të bëjë me shumicën e çështjeve dhe problemeve, me të cilat i riu i Deçanit ballafaqohet çdo ditë.

Plani i Veprimit Rinor Lokal Deçan synon që të përmirësoj gjendjen e të rinjve, duke përfshirë institucionet Lokale Qeveritare dhe jo Qeveritare në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të të rinjve duke gjetur mënyra dhe mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në qytetin e Deçanit.

Ky dokument bazohet në Strategjinë Kosovare dhe Planin e Veprimit për Rini që është dokument i Qeverisë së Republikës të Kosovës , i hartuar nga departamenti i Rinisë në **Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** .

- ***Kush e hartoi atë në Deçan***

Plani i Veprimit Rinor Lokal në Deçan është dokument i hartuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kuvendit Komunal në Deçan dhe me kontributin e shumë aktivistëve të rinj, **si dhe financues i projektit Departamenti i Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** .

Ky plan paraqet mënyrat e qasjes së politikave rinore komunale ndaj të rinjve dhe nevojave të të rinjve në qytetin e Deçanit.

- ***Çfarë mund të presin të rinjtë e Deçanit nga ky plan ?***

Plani i Veprimit Rinor Lokal Deçan është për të rinjtë e moshave 15 – 24 vjeç dhe çdo kush që i takon kësaj grup moshe do të përfitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mirëpo pa përjashtuar moshë, racë, gjini të tjera të shoqërisë .

Në plan, në bazë të politikave rinore të Sektorit të Rinisë të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport pranë Kuvendit Komunal të Deçanit ekzistojnë numër i veprimeve në zonat rurale dhe urbane të Deçanit.

Plani i Veprimit Rinor Lokal Deçan promovon bashkëpunimin ndërmjet organizatave Rinore dhe Qeverisë Lokale dhe në të njëjtën kohë ndërlidhë politikën ndër-sektoriale në mes të drejtorive të ndryshme pranë Kuvendit Komunal të Deçanit, që ndërlidhet me të rinjtë në fushën e politikave dhe programeve rinore.

Ky plan mund të pasurohet edhe më tutje duke kontaktuar drejtpërdrejt Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport përkatësisht Sektorin e Rinisë.

PLANI I VEPRIMIT LOKAL RINOR (2023-2026) DEÇAN

- **Themelimi i Këshillit i Veprimit Rinor Lokal në Deçan**

Pas fillimi të zbatimit të planit (duke filluar përgaditjet gjatë procedurës së hartimit të planit deri në miratimin e tij), Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, do të angazhohet për Themelimin e Këshillit Lokal të Veprimit Rinor (KVRL) , në të cilin do të ftohen për konsultime dhe dhënie të kontributit të tyre shumë organizata jo qeveritare, si dhe grupet tjera formale siç janë ato të shkollave të Mesme të Deçanit.

Këshilli i veprimit Rinor Lokal do të perbehet nga perfaqshuesit e të gjitha OJQ-ve Lokale ku do të perzgjedhen delegatet nga ata perfaqshues qe mund te kontribuojnë direkt ne implementimin e këtij plani.

Strukturat KVRL-së, si vijon :

1. Kryetari i KVRL-së
2. Nënkryetari i KVRL-së
3. Tre anëtar të kryesisë
4. Këshilli duhet të përbëhet prej 7 antarësh te KVRL-së ne Deçan.

- **Pse duhet të ekzistoj KVRL-ja**

Sepse rinia Deçanase ka pasur nevojë që të ketë një organ të vetin të organizuar për të ndikuar në vendim marrje dhe në të njëjtën kohë për të hulumtuar opinionin, gjendjen e rinisë, dhe të bashkoj organizata të ndryshme brenda një trupi me qëllim të plotësimit të nevojave të cekura më lart.

- **Çka është KVRL-ja**

Këshilli Veprimit Rinor Lokal (KVRL) është mekanizëm nëpër mes të cilit rinia Deçanase mund t'i adresojë brengat, shqetësimet dhe rekomandimet e veta tek Kryetari i Komunës .

Pra Këshilli Veprimit Rinor Lokal është organ këshillë dhënës për rini i Kryetarit të Komunës e në të njëjtën kohë është edhe hulumtues i gjendjes së rinisë në Komunë, dhe mekanizëm me ndikim në procesin e vendim marrjes .

- **A mund të marr pjesë**

Po nëse jeni anëtar i ndonjë organizate jo qeveritare, apo i ndonjë grupi tjetër rinor të organizuar dhe jeni të moshës 15 – 24 vjeç. KVRL ka për detyrë që të mbaj Kuvende vjetore, në të cilat Kuvende mund të jeni pjesëmarrës i deleguar .

Po ashtu përmes projekteve të implementuara nga Këshilli Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në çdo kohë dhe në çdo vend mund të jeni pjesë e tyre.

POLITIKAT E SEKTORIT TE RINISE SË DEÇANIT

Sektori i Rinisë ne kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport pran Kuvendit Komunal të Deçanit vepron në këto politika rinore:

- Stimulimi i talenteve te rinj apo te reja.
- Mbështetja e të rinjve nga zonat rurale në ide dhe projekte që vijnë prej tyre.
- Shkëmbimi i përvojave dhe informatave në mes te rinjve.
- Integrimi i të rinjve për brenda qytetit të Deçanit.

- Politika e punësimit të të rinjve.
- Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i dukurive negative.
- Fuqizimi i rolit të rinisë në vendimmarrje.

Këto politika hartohen në koordinim të plotë në mesë shoqërisë civile dhe sektorit të rinisë në komunën e Deçanit.

FUQIZIMI I QENDRES RINORE

Qendra Rinore është vend ku të rinjtë e kanë si vend takim por edhe si vend ku mund të iniciohen dhe projektohen projektet e ndryshme me karakter rinor. Kjo qendër ka nevojë të fuqizohet më dy përgjegjës aktiv me qëllim që të jetë e hapur çdo ditë.

12 GUSHTI – DITA NDERKOMBETARE E RINISE

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të rinisë në Deçan parashihen aktivitete gjithëpërfshirëse në qendrën rinore me ftesë të veçantë për të rinjtë që vijnë nga diaspora ku mund të përfshihen edhe sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Arsimit.

SHËRBIMI PËR PAQE

Në kuadër të këtij projekti Shërbimit për Paqe organizuar me grupe rinore shumë etnike, është menduar puna vullnetare në qendra dhe pjesë të ndryshme të qytetit, siç janë: shtëpitë e shëndetit, çerdhet e fëmijëve, qendra strehimore, qendrat e kujdesit social, në të cilat këto grupe do të ndihmonin në pastrimin e këtyre qendrave, organizimi i shënimit të datave ndërkombëtare dhe shtetërore.

AKTIVITETE KULTORORE (PIKTURE, MUZIKE , ART) 2023-2026

Në kuadër të këtyre aktiviteteve është menduar që të kemi projekte të ndryshme me karakter garues në tërë Deçanin, dhe jo vetëm të karakterit ndëretnik por edhe me gjerë.

SHENIMI I DITES NDERKOMBETARE TE AMBIENTIT 2023-2026

Dita ndërkombëtare e ambientit do të jetë njëra prej mundësive më të mëdha që të rinjtë apo të rejat të jenë më kreativ në shënimin e kësaj date, përmes programeve të ndryshme të ideuar nga vetë të rinjtë dhe të përkrahur nga Kuvendi Komunal, Qeveria e Kosovës dhe donatorë të tjerë.

SEMINARE 2023-2026

Seminar të ndryshme me tema të ndryshme do të jenë mundësi shtesë që të nxirren edhe rekomandime por edhe të plotësohet gjatë implementimit të planit veprues për rininë në Deçan.

MBESHTETJA E TË RINJEVE NGA ZONAT RURALE

KVRL do të mbështesë të rinjtë nga zonat rurale dhe do të bëjë rrjetëzimin e të rinjve në kuadër të Këshillit Veprimi Rinor Lokal në Deçan.

ANALIZA E NIVELIT TE ARSIMIT TË TË RINJEVE NE ZONAT RURALE JANAR-QERSHOR 2023

Meqenëse niveli i arsimit dhe pjesëmarrja e tyre në shkollë, sipas vlerësimit, është mjaft i ultë në zonat rurale atëherë është e domosdoshme në teren të mbledhen statistika dhe të rekomandohen institucionet arsimore dhe kulturore për mënyrën e ndikimit në zgjidhjen e këtij problemi. Pas analizave dhe mbledhjes së statistikave, po ashtu grupet e ndryshme rinore do të kenë mundësi që të krijojnë fokus-grupe, të cilat do të ishin pjesë e trajnimeve, seminareve, projekteve si dhe fokus-grupeve të ndryshme.

AKTIVIZIMI I KAMPEVE RINORE NE ZONAT RURALE 2023-2026

Pas analizave që do të duhet të bëhen në zonat rurale, është menduar që në këto zona të mbahen kampe të ndryshme me grupe të rinjve të cilat do të jenë kampe të edukimit jo-formale me të cilat do të organizoheshin seminare dhe trajnime të ndryshme nga OJQ-të e Deçanit dhe jashtë saj, të përkrahur nga sektori i Rinisë.

JAVA E TË RINJEVE BASHKËTDHETARE

KVRL- do të organizojë javën e të rinjve bashkatdhetar në hapësirat e Qendrës Rinore, si një aktivitet vullnetar nga të rinjtë e komunës së Deçanit ku do të ketë aktivitete të ndryshme si : Njohja në mes veti , përgatitje të ushqimit tradicional, shkëmbim përvojash dhe ideve .

ORGANIZIMI I KURSEVE PERIODIKE NE FUSHA TE ÇAKTUARA

Si në mësimin e gjuhës angleze, kompjuterëve, gazetarisë, aktrimit , muzikës , artit, dhe hartimit të projekteve.(**2023-2026**)

KVRL me bashkëpunim me sektorin e Rinisë si dhe Drejtorinë për Arsim do të organizojnë kurse të gjuhëve të huaja , dhe kurse të ndryshme si dhe për hartimin e projekteve për grupet jo formale që do të krijohen në fshatra.

RRJETIZIMI APO NËNDEGËT RINORE NË FSHATRA

Plani i veprimit rinor lokal do të jetë më i lehtë dhe i zbatueshëm me rrjetëzimin dhe krijimin e nëndegëve rinore në fshatrat e komunës së Deçanit të cilët do të jenë me afër aktiviteteve rinore në kuadër të KLVR. Për të zbatuar planin për Rini në zonat rurale është i domosdoshëm rrjetëzimi i grupeve jo-formale të të rinjtë nëpër fshatra, me kalimin e kohës këto grupe do të kishin mundur të jenë pjesë aktive edhe në proceset e vendimmarrjes.

MOTIVIMI I TË RINJEVE NE BIBLIOTEKA

Një ndër mënyrat e nxitjes së leximit janë menduar edhe biblioteka të vogla që të jenë funksionale nëpër fshatrat e komunës së Deçanit. Këto biblioteka do të mund të zbusnin analfabetizmin në mënyrë indirekte.

ORGANIZIMI I LOJËRAVE PA KUFI-POPULLORE

Në të kaluarën lojërat popullore kanë qenë shumë atraktive dhe kanë qenë pjesë e largimit të të rinjve nga rruga. Këto lojëra do të mund të organizoheshin në pjesët rurale të komunës së Deçanit në koordinim të plot me sektorin e rinisë dhe sportit si dhe drejtorinë së shëndetësisë në komunën e Deçanit.

TË RINJËT NË VENDIMARRJE

Kuvendi vjetor i KVRL-së

Në kuadër të Kuvendit vjetor të KVRL-së të rinjtë do të mund të ishin të përfshirë në krijimin e mekanizmit rinor, siç është Këshilli Veprimi Rinor Lokal edhe do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në këtë mekanizëm këshillë dhënës për Kryetarin e Komunës.

TRYEZA-DEBATE MBI ROLIN E TË RINJËVE NË VENDIMMARRJE

Është e rëndësishme që të vazhdohet me ngritjen e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë që ka shoqëria Deçanase, që të rinjtë të jenë pjesë e vendim marrjes. Sidomos në fushat që prekin jetën e tyre të përditshme, qoftë në institucionet edukative arsimore qoftë në institucionet tjera. Mbajta e këtyre tryezave do të mund të sillte rekomandime të shumta për institucionet lokale në mënyrë që të jenë në hap me kohën për qasje ndaj rinisë Deçanase.

KONFERENCA DITORE – TË RINJËT NË VENDIMMARRJE

Konferenca ditore e të rinjve do të duhej të organizohej nga KVRL-ja, në të cilën do të merrnin pjesë edhe të rinjtë nga qytetet tjera dhe përfaqësues të institucioneve, me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira dhe efektive nga të gjithë. Këto konferenca do të sillnin edhe donatorë të ndryshëm në pjesëmarrje, në mënyrë që ata të shohin interesimin, organizimin dhe funksionimin e të rinjve të Deçanit.

DITA E TRASHIGIMISË KULTURORE DEÇAN

Ky projekt nënkupton organizimin kolektiv të grupeve të ndryshme rinore për të vizituar objektet kulturore, fetare, muzetë, vendet e veçanta historike siç është: Kompleksi Memorial “Dëshmoret e Kombit në Gllogjan” apo vendet tjera të interesit nacional qoftë brenda apo jashtë qytetit. Ky projekt bëhet me qëllim që të rinjtë apo të rejtat e qytetit të Deçanit të njohin vendin dhe ambientin që i rrethon. Në kuadër të këtij projekti mund të ishin kyçur: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Arsim dhe ajo e Ambientit si dhe organizatat tjera jo-qeveritare.

ELIMINIMI I BARRIERAVE ARKITEKTONIKE NË QENDRAT EDUKATIVO-

ARSIMORE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në kuadër të kësaj politike është e domosdoshme që të ketë një angazhim më të madh nga drejtoritë përkatëse Komunale, që në qendrat edukative arsimore të ketë largim të barrierave arkitektonike, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje shumë më të mirë.

FUSHATA E VETËDIJESIMIT PËR REGJISTRIM NË QENDRAT PËR PUNË

Një ndër projektet që do të duhej të ishin të vazhdueshme janë edhe fushata për regjistrim, të cilat janë të domosdoshme për të parë dhe identifikuar numrin e të rinjve që përfundojnë shkollën dhe janë të papunë. Këto fushata vetëdijesimi do të duhej të ishin bërë në zonat rurale dhe urbane.

ORGANIZIMI DHE KËSHILLIMI NË KARRIERË

Orientimi i hershëm për profesion, duke filluar që nga shkolla fillore, meqë rast Drejtoria për Arsim do të mund të angazhonte një këshilltar apo më shumë këshillues të karrierës nëpërmjet Ministrisë së Arsimit.

ORGANIZIMI I TRAJNIMEVE PËR NDËRMARRËSI TË TË RINJËVE

Në kuadër të këtij aktiviteti do të mund të organizoheshin trajnime për nxitjen e bizneseve të vogla dhe të mesme duke u bazuar në idetë mbi biznes planet dhe idetë e të rinjve. Model ky i nxitjes së ndërmarrësve të të rinjve që aplikohet në BE.

STIMULIMI I TALENTEVE TË RINJ APO REJA

Organizimi i kuizeve të diturisë, krijimi i shoqërive kulturore artistike, krijimi i grupeve muzikore, prezantimi i këtyre vlerave etj.

Në kuadër të këtij projekti do të mund të hynin të rinjtë nga klasat e 9-ta deri tek ata që janë në Universitet. Këto kuize të diturisë do të nxirrnin talent në fusha të ndryshme dhe në fund fituesit do të stimuloheshin për kryerje të kurseve ose edhe për dhënie të bursave.

PANAIRI I SHKENCËS DHE KULTURËS

Qëllimi i këtij panairi është që nxënësit e shkollave të mesme të prezantojnë talentin e tyre duke promovuar të arriturat në mësim-nxënie.

TALENTET NË SPORT

Projekti talentet në sport do të fus mekanizmin e marrëveshjeve me klube sportive dhe shkolla të sportit përmes Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sporteve si dhe Drejtorisë së Arsimit, që të rinjtë të bëhen anëtarë të klubeve që nga shkollat e tyre.

9 MAJI DITA E EVROPËS

Festimi i ditës së Evropës përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse rinore, me partneritet të plotë në mes të sektorit të rinisë, KVRL-së , organizatave të rinisë si dhe partnereve të tjerë të cilët do të stimulonin njohurit për bashkimin Evropian dhe nxjerrjen e kualiteteve mbi këto njohuri.

EDUKIMI SHËNDETËSOR DHE PARANDALIMI I DUKURIVE NEGATIVE

Projektet në kuadër të kësaj politike do të duhej të ishin të lidhura me shënimin e datave ndërkombëtare siç janë:

- **24 Marsi dita e Evropiane e Parqeve**

Në kuadër të kësaj date, do të udhëheqshin fushata vetëdijesimi nëpërmes këshillave rinor të shkollave të mesme, për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e parqeve si dhe për pengimin dhe shkatërrimin e tyre.

- **31- MAJI DITA NDËRKOMBËTARE KUNDËR DUHANIT**

Ky projekt në koordinim të plotë me Drejtorinë e Shëndetësisë, do të jepte mundësinë e organizimit të debateve dhe tryezave të ndryshme kundër duhanit por edhe do të jepnin mundësinë e zbatimit të ligjit kundër duhanit.

- **28 QESHORI DITA KUNDËR NARKOTIKËVE**

Në këtë ditë me organizime dhe seminare të ndryshme do të mund të ngrihej vetëdija për pasojat që sjell narkomania dhe në të njëjtën kohë do të mund të merreshin më shumë udhëzime mbi parandalimin të kësaj dukurie.

- **1 DHJETORI DITA NDËRKOMBËTARE KUNDËR HIV-AIDS**

Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetësisë publike dhe sektorin e Rinis do të organizohen debate në qytetin e Deçanit për të dhënë informacione dhe për të ngritur shkallen e vetëdijes tek të rinjtë për Hiv-Aids.

IDENTIFIKIMI DHE PARANDALIMI I DUKURIVE NEGATIVE NË SHKOLLA

Në kuadër të planit veprues mbi identifikimet dhe parandalimin e dukurive negative në shkolla, mendohet të organizohen takime, tryeza dhe debate mbi mundësinë dhe mënyrat e parandalimit për të njëjtën kohë edhe ofrimin e partneritetit si dhe përkujdesjes institucionale të të rinjve në shkolla.

MUAJI I RINISË- 17 SHTATORI

Muaj i rinisë është aktivitet tradicional, që organizohet nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, me bashkëpunim me sektorët e Rinisë pranë Drejtorive përkatëse nëpër Komuna. Ky aktivitet tashmë tradicional organizohet në tërë Kosovën dhe ka karakter garues.

Qëllimi i Muajit të Rinisë është mobilizimi i të rinjve në tërë Kosovën në këtë rast edhe në Komunën tonë, rreth aktiviteteve të shumta që kanë për qëllim bashkëpunimi në mes të rinjve, sensibilizimi e opinionit për rolin e rëndësishëm të rinisë në shoqëri dhe përkushtimin e institucioneve dhe organizatave përkatëse ndaj rinisë.

Në kuadër të Muajit të Rinisë çdo qytet i Kosovës ka ditën e vet për organizimin e aktiviteteve kryesore. Dita e Rinisë në Komunën tonë është në Shtatori. Ky aktivitet organizohet me organizatat rinore dhe shoqëria civile.

ORGANIZIMI I SPORTIT DIMËROR (SKIJIM)

Ky aktivitet parashihen të organizohen në kompleksin e Alpeve Shqiptare prapa pushimores së fëmijëve ku të rinjtë Deçanas mund të tregojnë talentin e tyre në skijim.

GARA NE CIKLIZEM

Keto gara parashihen të organizohen në pjesët rurale të Deçanit, këto gara do të kenë karakter garues komunal.

SHFAQJET TEATRALE

Duke marrë parasysh nevojën e madhe për art nga qytetaret e Deçanit e kemi parë të arsyeshme që të kemi një pjesë të artit në Komunën e Deçanit, ku do të ketë shfaqje të ndryshme teatrale.

EVENIMENTET OSE NGJARJET

Me evinimente është paraparë që do të zhvillohen ngjarje të ndryshme në kohë të pacaktuar me plan të KVRL-s dhe me kërkesa të veçanta nga të rinjtë.

17 SHKURTI

Me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës KVRL do te organizoj në palestrën e Gjmnazit “Vëllezërit Frashëri”, të sportit Futsall me karakter Komunal.

16 QERSHORI

Me rastin e 16 Qershorit Ditës se Çlirimit të Deçanit KVRL ne bashkëpunim me grupet vullnetare do të organizoj aktivitete kulturore-sportive.

DITA E STUDENTËVE

Me këtë eveniment është paraparë që të jetë një ditë e veçantë me studentët e Komunës së Deçanit dhe ku do të ketë njohje në mes studentëve dhe të ketë shkëmbim idesh ne mes tyre.

BUXHETI I PARAPARË PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË PARAPARA

Objektivat e Politikës	Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Institucionet përgjegjëse	Institucionet partnere	Afati kohor			Buxheti
					2023	2024	2025	
	Fuqizimi i qendrës rinore	Krijimi kushteve elementare me dy përgjegjës aktiv me orar te shkurtuar kater ore ne dite me pag mujore 75€ per person	DKRS	MKRS dhe partner te ndryshëm	500	1700	1700	3900€
	12 Gushti dita Ndërkombëtare e Rinisë	Promovimi i vlerave kulturore-sportive	DKRS	OJQ-të	400	400	400	1200€
	Shërbimi për paqe (organizimi i kampanjave për dhurimin e gjakut dhe aktivitete solidarizuese	Promovimi i punës vullnetare me grupe multietnike ne qytet	Spektori i Rinise	DSHMS,OJQ		250	250	500€
	Aktivitet kulturore, gara të ndryshme në pikturë, art, muzikë, etj.	Promovimi i vlerave multietnike me karakter garues	Spektori i Rinise	DASH, OJQ,MKRS		400	400	800€
	Shënimi i ditës ndërkombëtare te ambientit	Promovimi i rëndësisë se ruajtjes se ambientit, pastrimi i qytetit	Drejtori e Ambientit dhe arsimit dhe partner te tjerë	DKRS, dhe OJQ dhe grupet vullnetare		250	250	500€

	Seminaret	Nxjerrja e nevojave plotësuese për të rinjtë si dhe marrja e ideve për plotësimin e PVRL	DKRS	MKRS, OJQ		300	300	600€
	Analiza e nivelit të Arsimit të të rinjve në zonat rurale.	Mbledhja e të dhënave të sakta mbi gjendjen e shkollimit të të rinjve në zonat rurale.	DASH	DKRS,OJQ	200	200	200	600€
	Kampet rinore tre ditore.	Përmirësimi i gjendjes së të rinjve në zonat rurale	DKRS	Grupet jo formale në zonat rurale , OJQ-të		500	500	1000€
	Organizimi i Kurseve të Gjuhës Angleze , Kompjuterëve ,dhe Hartimin e Projekteve.	Ngritje e nivelit të rinjve në Zonat Rurale në këto fusha	DASH	DKRS MASHT		1200	1200	2400€
	Themelimi i grupeve jo formale të të rinjve në zonat rurale.	Aktivizimi i të rinjve në mënyrë të organizuar	DKRS	OJQ-të rinore	0	0	0	0
	Motivimi i të rinjve në biblioteka	Ofrimi me librin dhe nxitja për arsimime përmes këtyre bibliotekave	DASH	MASHT, Biblioteka nder-komunale dhe donator tjerë .	200	200	200	600€
Organizimi i lojërave popullore në fshatra.	Aktivizimi i rinis që të jenë aktiv dhe ringjallja e lojërave tradicionale .	Spektori i Rinisë dhe Sportit.	Klubet e ndryshme sportive OJQ-ve			500	500	1000€

Kuvendi Vjetor i KLVR-së	Zgjedhja e organeve Drejtuese,dhe raportimi i punës një vjeçare të KLVR-së	Organet drejtuese të KVRL-së	DKRS MKRS		300	300	600€
Tryezë ,debate roli i rinisë në vendim marrje	Nxjerrja e rekomandimeve mbi mundësinë e rinisë dhe rolin e tyre në vendim marrje.	DKRS	KVRL		350	350	700€
Konferenca ditore e të rinjtë në Vendim marrje.	Nxjerrja e mënyrave të bashkëpunimit, nder-komunal për forcimin e rinisë.	KVRL	DKRS	450	450	450	1350€

Dita e Trashëgimisë kulturore në Deçan	Promovimi i vlerave Historike,kulturore,të trashëgimisë si dhe atyre fetare përmes vizitave të organizuara,me ciceron.	DKRS	MKRS KVRL	350	350	350	1050€
Eliminimi i barrierave Arkitektonike në qendrat edukativo - arsimore	Lehtësimi i qarkullimit për persona me aftësi të Kufizuara.	Drejtoria për Urbanizëm dhe planifikim Hapsinor	Bizneset dhe Handikos	0	0	0	0€
Fushata e vetëdijesimit për regjistrimin në entin për punësim(ZKP)	Rritja e të regjistruarve në qendra.	Enti për Punësim	DSHMS, OJQ-të		150	150	300€

Panairi i Shkencës dhe Kulturës	Nxjerrja e talenteve të rinj duke promovuar të arriturat me mësimnxënie	DASH, DKRS	KVRL ,Grupet Vullnetare		400	400	800€
Talentet në Sporte	Ngritja e bashkëpunimit në mes të klubeve sportive,organizata të rinjve ,Sektori i Sportit	DKRS	Klubet Sportive,KVRL	400	400	400	1200€
Dita e Evropës 9 Maj	Nxjtja e të rinjve për njohuritë për Bashkimin Evropian dhe shënimi i kësaj date.	DKRS	Zyra e Bashkimit Evropian		500	500	1000€

Java e maturantëve	Aktivitete kulturoro – argëtuese	KVRL	Këshillat e nxënësve të shkollave të mesme	4500	450	450	1350€
24 Marsi dita evropiane e parqeve	Ngritja e nivelit të vetëdijes tek të rinjtë për rëndësinë e ruajtjes së parqeve si dhe për efektin e tyre në shëndetin e njeriut.	DAPH	DKRS,KVRL, Grupet Vullnetare.		500	500	1000€
31 Maji dita ndërkombëtare kundër Duhanit.	Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të duhanit dhe rrezikun që sjell tek njeriu.	DSHMS	MKRS,KVRL Grupet Vullnetare		500	500	1000€
28 Qershori dita ndërkombëtare kundër narkotikëve.	Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të	DKRS	DSHMS,MKRS KVRL,	f	400	400	800€

	narkotikëve, si dhe mënyra e parandalimit të kësaj dukurie		Grupet Vullnetare				
1 Dhjetori dita ndërkombëtare kundër HIV-AIDS-it	Përmes shënimit të kësaj date do të presim që niveli i njohurive tek të rinjtë dhe mënyra e parandalimit të kësaj sëmundje të rritet.	MKRS	DSHMS	500	500	500	1500€
Tryeza me temën dukuritë negative në shkolla dhe mënyra e parandalimit.	Përmes këtyre tryezave do të dëgjohet zëri i nxënësve të mesëm lidhur me dukuritë negative.	DASH	MASHT KVRL	300	300	300	900€
Muaji i Rinisë	Mobilizimi i Rinisë , Bashkëpunimi në mes veti si dhe promovimi i rolit të rinisë në Shoqëri	DKRS, MKRS	KVRL, Grupet Vullnetare	600	600	600	1800€

Organizimi i sportit dimëror (skijim)	Aktivizimi i të rinjve në kete sport atraktiv	DKRS KVRL	Grupet vullnetare		300	300	600€
Gara në ciklizem	Mobilizimi i të rinjve për sporte atraktive	DKRS Federata për ciklizem	KVRL Grupet vullnetare OJQ-te		500	500	1000€

Shfaqje teatrale	Mobilizimi i të rinjve për artin	DKRS	Teatrot lokale etj.		1000	1000	2000€
Evenimentet Ose ngjarjet	Organizime të ndryshme si festivale Koncerte et.	DKRS KVRL	OJQ-te Grupet vullnetare				Shuma sipas kërkesës
17 Shkurti	Aktivitetet sportive me karakter Komunal	DKRS	KVRL OJQ-te Grupet vullnetare		900	900	1800€
Dita e Studenteve	Njohja e studenteve në mes veti.	KVRL	OJQ-t studentore		450	450	900€
Pagesa për stimulim të strukturave KVRL-se	Pages e cila do të ndahet nga Kryetari i KVRL-se	KVRL	KVRL	1000	1000	1000	3000€

Shuma e përgjithshme e buxhetit për PVRL-në	Total: 36.850€
--	-----------------------

01.Nr.VI ,
Deçan,dt.30.06.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



DRAFT

PLANI KOMUNAL PËR BARAZI GJINDORE 2023-2027



PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Komunës.....	3
Vendimi.....	4
Indeksi i shkurtesave.....	5
Indeksi i tabelave.....	6
1. Hyrja	7
1.1 Baza ligjore për barazi gjinore.....	8
1.2 Qëllimi dhe objektivat e planit komunal për barazi gjinore 2023-2027.....	9
1.3 Metodologjia.....	12
2. Analiza e përgjithshme gjinore në komunën e Deçanit.....	13
3. Plan komunal veprimi për barazi gjinore, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2027.....	18
4. Plan i monitorimit të zbatimit të Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027.....	27
5. Plan i monitorimit dhe vlerësimit	29



Kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju njoh me Planin Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, i cili është dokumenti i rëndësisë së veçantë për qytetarët e Deçanit dhe Institucionin Komunal, njëkohësisht, për faktin që ky plan është hartuar për katër vite dhe përcakton se; barazia gjinore është njëra ndër vlerat themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë prandaj është edhe qëllimi im, që t'i mënjanoj pengesat duke garantuar sjellje, pozitë, mundësi dhe përfitime të barabarta për të dy gjinitë në të gjitha sferat e jetës, duke detyruar institucionet ta zbatojnë nga afër me përpikëri këtë plan.

Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes në fushën e barazisë gjinore në territorin e komunës. Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të çdo trajtimi jo i barabartë i një individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme ku do të konsiderohet diskriminim i drejtpërdrejtë gjinorë, andaj me këtë plan komunal plotëson një prej kërkesave për hartimin e dokumentit, specifikimin e aktiviteteve për realizimin e projekteve me synim të realizimit të objektivave komunale.

Planin Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 është me përpushmëni me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Planit Kombëtar për Veprim 2020-2023. Ky dokument do të ndihmojë po ashtu edhe në përmbushjen dhe zbatimin e politikave për barazi gjinore nacionale dhe plotësimin e kërkesave për realizimin e objektivave që dalin nga dokumentet strategjike në nivelin komunal.

Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese të barazisë gjinore, identifikuar problemet ku janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme të planit të punës për periudhën katër vjeçare në fushën e barazisë gjinore në komunën e Deçanit.

Për implementimin e këtij plani komunal do ta bëjë nëpërmjet të Zyrës për Barazi Gjinore me koordinimi timin po ashtu do të bëjë edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por, njëkohësisht, ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët, për implementimin e projekteve të këtij plani.

Përkushtimi im si Kryetar i Komunës, do të jetë i përqendruar në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Deçanit, duke e mbështetur fuqishëm zhvillimin dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe barazisë gjinore prioritet dhe vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë.



BASHKIM RAMOSAJ
KRYETAR I KOMUNES SË DEÇANIT

Vendimi për hartim të Planit Lokal për Barazi Gjinore 2023-2027



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore (Gazeta Zyrtare, Nr.16, 26 qershor 2015), nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, sipas nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.05.2022, bie këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN PLANIT PËR BARAZI GJINORE PËR KOMUNËN E DEÇANIT 2022-2026

I.

Formohet grupi punues për hartimin e Planit për Barazi Gjinore për Komunën e Deçanit 2022-2026, në këtë përbërje: Zoje Sejfiqaj, zyrtare për barazi gjinore, 2 Ajne Ibërhyssaj, Inspektore e Ambientit, 3.Yllarta Thaqi, nga Asambleja (AAK),4.Hyri Dobrunaj, nga Asambleja(LDK), 5.Teuta Neziraj, nga Asambleja (LVV).

Mbledhjen e parë të Grupit punues e fton Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Grupi e zgjedhë kryesuesin e vet.

II.

Grupi është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe ofrimin e informatave të nevojshme gjatë dhe deri në përfundimin e procesit të finalizimit të hartimit të Planit për Barazi Gjinore për Komunën e Deçanit 2022-2026

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen:Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

IV.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.VIII-6

Deçan,dt.30.05.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Indeksi i shkurtesave

ABEF - Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ABGJ - Agjencia për Barazi Gjinore
AFP - Anketa e Fuqisë Punëtore
AP- Avokati i Popullit
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPGJ - Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
CEDAW - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
IEBGJ - Instituti Evropian për Barazi Gjinore
KNKDHf - Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje
LBGJ - Ligji për Barazi Gjinore
LGBT - Lesbike, Gej, Biseksualë, Transgjinorë
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MATP - Masat Aktive të Tregut të Punës
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKBGJ - Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
PKBGJ- Plani Komunal për Barazi Gjinore
PSV - Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
QAP - Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS - Qendrat për Punë Sociale
RrGGK - Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
ShC - Shoqëria Civile
ZBGj - Zyrtari/ja për Barazi Gjinore
ZKM Zyra e Kryeministrit të Kosovës
ZMNv Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Indeksi i tabelave

Tabela1 : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitin 2023-2025

Tabela 2: Shpenzimet Komunale për (Vitin 1-3) 2023-2025

Tabela 3: Numri i punëtorëve në komunën përkatëse për vitin 2023

Tabela 4: Planifikimi për vitin 2024 Niveli i pagave në Komunë

Tabela 5: Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe shërbimeve të ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është aplikueshme)

Tabela 6: Plani i veprimit barazisë gjinore, prioriteti dhe aktivitetet për periudhën 2023-2027

Tabela 7: Plani i monitorimit të zbatimit të Planit Lokal për Barazi Gjinore 2023-2027

1.Hyrja

Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe prej 293,948,468.50 m² ose 293,94 km², e cila gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, me 38 vendbanime, 136 banorë për km².

Plani Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, trajton barazinë ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore në komunën e Deçanit.

Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore, në të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutivë, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për t'i zbatuar masat legislative si dhe masat tjera duke përfshirë edhe miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2024 dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2020-2022 prandaj Komuna e Deçanit me këtë plan komunal, ka specifikuar aktivitetet me qëllim të realizimit të objektivave për barazi gjinore.

Barazia gjinore është një e drejte themelore e përcaktuar si një parim fundamental në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ku konsiderohet faktor i rëndësishëm për zhvillim ekonomik, mirëqenie sociale dhe stabilitet, ku ky plan komunal për barazi gjinore për periudhën katër vjeçare 2023-2027 është përqendruar në tri shtylla kryesore:

- Shtylla e I-ë: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale
- Shtylla e II-të: Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore
- Shtylla e III-të: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguri

Përkushtimi për barazi gjinore thekson domosdoshmërinë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave, komunale duke u respektuar kornizën ligjore dhe ofrimin e mirave dhe shërbimeve për të arritur qëllimin e përcaktuar për barazi gjinore.

Arritja e barazisë gjinore e parapare edhe me Ligjin për Barazi Gjinore m. 05/L-020, i cili thekson se; barazia gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi po ashtu kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet e ndryshme si ato të arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve etj.

Me anë këtij Plani komunal, komuna e Deçanit synon të japë ndihmesën në arritjen e standardeve me të larta në trajtimin e barazisë gjinore. Ky plan komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor për barazi gjinore kombëtare si dhe akteve tjera nënligjore dhe politikave publike për barazi gjinore.

1.1 Baza ligjore për barazi gjinore

Hartimi i Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 është obligim që del nga Ligji për Barazi Gjinore 05/L-020 specifikisht, neni 5, paragrafi 1.2, i cili obligon institucionet e Republikës së Kosovës të miratojnë strategji dhe plane të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore.

Ky ligj në paragrafin 1.3 obligon institucionet të përfshijnë integrimin gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacionin, sigurimin e barazisë gjinore në proceset e përzgjedhjes dhe caktimit në punë duke përfshirë pozicionet drejtuese duke siguruar përfaqësim të barabartë edhe në konferenca, mbledhje, trajnime dhe duke siguruar burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe(plane) projekte dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore.

Ligji gjithashtu obligon institucionet edhe për mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë dhe shpërndarjes së tyre por edhe obligon institucionet publike të ndërmarrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të arritjes dhe realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në fushat ku ekzistojnë pabarazi.

Ky plan komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 është hartuar duke konsideruar instrumentet, kornizë ligjore dhe politikat kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave, ligjet më kryesore janë si në vijim.

Korniza ligjore dhe politikat vendore për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për barazi Gjinore Nr. 05/L-020;
- Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje Nr. 03/L-182;
- Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26;
- Ligji i Familjes Nr.2004/32;
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.05/L-021;
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154;
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212.

Korniza zhvillimore vendore dhe veprimet për promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e Grave:

- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Nacionale dhe Plani i veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve,
- Qarkorja Vjetore Buxhetore, dhe
- Strategjitë e tjera.

Parimet kryesore të cilat janë marr parasysh për hartimin e këtij planit janë:

- Të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut
- Barazia gjinore është kontribuues për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë
- Komuna duhet të posedoj kapacitete për të integruar barazinë gjinore dhe avancuar fuqizimin e grave.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e planit komunal për Barazi Gjinore 2023-2027

Qëllimi i Planit Komunal për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të gjitha proceseve e aktiviteteve politike, projekteve dhe programeve të qeverisë në komunën e Deçanit.

Shtylla I-ë: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale

Objektivi strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për dy gjinitë për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.

Ky objektivi ka për qëllim të sigurojë të avancojë fuqizimin ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale të grave, duke përmirësuar shpërndarjen, promovimin e drejtave me anë të punëtorive dhe trajnimeve, mbështetjen dhe pjesëmarrjen e grave në menaxhimin e burimeve. Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e dy objektivave specifik të mëposhtëm:

Rritja e punësimit të grave dhe vajzave

Synimi kryesor i këtij objektivi specifik është të sigurohen mundësi për rritjen e aktivizimit të grave në tregun e punës dhe rritjen e shkallës së punësimit të tyre. Për të arritur këtë objektivi, aktivitetet do të kryhen në drejtimet në vijim:

- Ngritja e shkathhtësive të grave, me anë të punëtorive, kurseve, trajnimeve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Promovimi i drejtave me anë të organizmit të punëtorive me qëllim të njohjes drejtën kundër diskriminimit në punësim, pushimin e lehonisë dhe pushimin atësor, në pajtim me direktivën e BE-së për balancë të jetës dhe punës;
- Promovimi, fushata sensibilizuese, duke ofruar njohuri me anë të punëtorive, ofrimi i qasjes në shërbime sociale dhe familjare cilësore, dhe persona me aftësi të kufizuara, duke lehtësuar kështu mundësitë e grave për tu aktivizuar në tregun e punës; dhe
- Fushata njoftuese për mbështetjen financiare, për të rritur angazhimin e grave në ndërmarrësi dhe rritjen e bizneseve në pronësi të grave.

Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime.

Synimi kryesor i këtij objektivi specifik është të sigurohet që gratë kanë qasje të barabartë në të drejta, burime dhe shërbime. Më specifikisht ky objektivi synon të sigurojë shpërndarje të barabartë në mbështetjen financiare, financa dhe shërbime.

Aktivitetet do të kryhen në këto drejtime:

- Fushata, punëtori rreth zhvillimit të udhëzuesve, dhe ngritjes së kapaciteteve për të mundësuar zbatimin e plotë dhe të saktë të Ligjit për Barazi Gjinore dhe konventave dhe standardeve ndërkombëtare për barazi gjinore.

Duke përfshirë edhe analizën buxhetore për barazi gjinore duke i përfshi trajnime punëtori për ngritjen e kapaciteteve për mënyrën e zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;

Integritet të perspektivës gjinore në politikat publike, shpërndarjes së informatave dhe mbështetjes në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të dy gjinive. Realizimi i të drejtës në pronë dhe trashëgimi

Shtylla e II-të: Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore

Objektivi strategjik 2: Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore. Synohet të arrihet përmes këtyre veprimeve:

- Organizimin e aktiviteteve vetëdijësuese, punëtori dhe trajnime me dy gjinitë dhe grup moshë të ndryshme për t'i kontribuar parandalimit të braktisjes së shkollimit;
- Krijimin e mundësive dhe i qasjes në shërbime për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve;
- Krijimin e skemave mbështetëse për vajzat dhe gratë për t'u angazhuar dhe avancuar në punë;
- Trajnime dhe punëtori rreth pasojave që mund të sjellë përdorimi i gjuhës së stereotipeve, gjuhës dhe praktikës pedagogjike diskriminuese nga plan programet dhe tekstet mësimore;
- Ngritjen e kapaciteteve të sistemit arsimor për ti zbatuar mekanizmat ekzistues për arritjen e barazisë gjinore;
- Përkrahje financiare për avancim profesional (studentet, bizneset fillestare) etj.
- infrastrukturë dhe ndërgjegjësim publik për ngritjen e pjesëmarrjes së vajzave, grave në sport;
- Trajnime dhe punëtori rreth pasojave që mund të sjellë në shoqëri si dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm;
- Monitorimi dhe vlerësimi në të tri fushat duke përfshirë: Integrimin e të dhënave personale në SISH për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës (duke përfshirë edhe dhunën ndaj grave në të gjitha format);
- Trajnime dhe punëtori mbi praktikën e planifikimit familjar;
- Trajnime dhe punëtori rreth programeve edukative dhe vetëdijësuese, me fokus të veçantë shëndetin riprodhues;
- Trajnime dhe punëtori rreth për trajtim dhe monitorim për përmirësimi i qasjes në shërbime në vendet rurale; ngritja e kapaciteteve profesionale (për promovim dhe edukim

shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojat specifike shëndetësore të femrave dhe meshkujve;

- Trajnime dhe punëtori rreth organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për shëndetin mendor (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, seksualiteti, etj.);
- Trajnime dhe punëtori rreth trajnimit të mësimeve në shkollat komunikim për shëndetin riprodhues dhe seksual;
- zgjerimi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë, si dhe përfshirja e shtuar në këto vizita të nënave dhe fëmijëve të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptase; dhe

Shtylla e III-të: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguri

Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore, do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve kryesore:

- Trajnime dhe punëtori rreth përfshirjes së normave jo diskriminuese, në përputhje dhe me kërkesat e Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) të Kombeve të Bashkuara 2030; Infrastrukturës ligjore Kombëtare, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Planit Kombëtar për Barazi Gjinore 2020-2022
- Sensibilizimit shoqëror për përmbushjen e të drejtave të grave të cilat janë të parapara me ligje por dhe luftimi i fenomeneve negative siç është dhuna në familje, stereotipet gjinore, mentaliteti patriarkal; mbi të gjitha të garantohet pjesëmarrja e barabartë gjinore në vendimmarrje; trajnime, punëtori dhe sensibilizim duke organizuar aktivitete për ndërgjegjësim dhe vetëdijësim për barazinë gjinore si dhe fuqizimi i grave asamblistë konsiderohet i rëndësishëm; organizimi i fushatave vetëdijësuese për të inkurajuar gratë për tu bërë pjesë e sektorit të sigurisë; dhe
- Organizimi i debateve publike për përfaqësimin e grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit.

1.3 Metodologjia

Metodologjia për hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 është gjithëpërfshirëse përfshin këto faza kryesore:

- Mbledhja e të dhënave, selektimi dhe shqyrtimi analiza e problemeve;
- Hartimin e planit të veprimit me aktivitete dhe veprime të bazuara sipas metodës SMART;
- Konsultimet me: arsim, shëndetësi, shoqërinë civile, shoqata të grave, grupe të interesit, biznese, subjekte politike, klube kulturore dhe publike.

Parimet kryesore në hartimin e PLBGJ-së janë:

- Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut,

- Barazia gjinore është kontribues i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm në gjitha sferat e komunës,
- Komuna e Deçanit është e përkushtuar për të promovuar llogaridhënien përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në vendimmarrje, politikë, qeverisje të mirë.
- Gjatë hartimit të planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 është hartuar në koordinim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe të gjithë mekanizmat e tjerë.
- Duhet theksuar se konsultime do të bëhen me qëllim që të gjeturat, propozimet me veprime konkrete për të kontribuar në arritjen e objektivave të këtij plani.

Mbledhja e të dhënave, shqyrtimi dhe analiza e problemeve:

Për tri shtylla të Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 pas hartimit të draft dokumentit dhe finalizimit të tij.

- Agjencia e Statistikave të Kosovës është përdorur si burim kryesor i të dhënave, ky orientim është përcaktuar për të siguruar disponueshmëri të dhënave për përcjelljen e indikatorëve të synuar.

Gjetjet nga analiza e gjendjes janë diskutuar në grupe punuese, ku edhe është arritur pajtueshmëri për problemin dhe sfidat që duhet adresuar në kuadër të Planit të Veprimit me projekte, kosto sipas metodës SMART.

2. ANALIZA E PËRGJITHSHME GJINORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

3.4	Trajnimi në punë dhe punësimi i të riatdhesuarve apo të huajve përmes subvencionimit të pagës;	Ndërmjetëso për trajnim përmes punës personat në nevojë për përgatitjen për tregun e punës; Monitoro mbarëvajtjen e trajnimit dhe punësimit;	Numri i rasteve të ndërmjetësuar për trajnim dhe përgatitje për tregun e punës; Numri i rasteve të monitoruara	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Bizneset Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP dhe QAP
3.5	Vetëpunësimi i të riatdhesuarve apo të huajve përmes financimit të planeve të biznesit;	Informo këta persona për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë; Informo këta persona	Numri i të riatdhesuarve apo të huajve që informohen për mundësitë dhe kushte të përfitimit përmes planeve të biznesit	ZP	DRPRIH ZKKK QAP Organizatave vendore dhe	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		kur thirrja të jetë e hapur për aplikim; Ndihmo këta persona në kompletimin e dosjes për aplikim;			ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
3.6	Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe te te huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës;	Identifiko personat e riatdhesuar dhe te huaj që kanë nevojë për aftësim profesional; Identifiko profilin e tyre dhe orientoj ata ne profesionet adekuate me prirjet dhe dëshirat e tyre; Referoj ata në QAP përkatëse;	Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që vijnë në aftësimin profesional Numri i të riatdhesuarve apo te huajve të profilizuar dhe orientuar për AP Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që referohen në QAP	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Bizneset	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP me të dhënat e të riatdhesuarve dhe të huajve që vijnë në aftësimin profesional
3.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP);	Monitoro në baza të rregullt rregulltarëvajtjen e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP); Vlerëso ndikimin e tyre ne përgatitjen dhe ri integrimin e PR;	Numri i të riatdhesuarve de te huajve që përfitojnë nga MATP ; Të dhëna për ndikimin e MATP në riintegrimin dhe integrimin e tyre	ZP DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)	ZKKK APRK Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet periodike te monitorimit dhe vlerësimit të përgatitura nga DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)
3.8	Mbështetja me grante, mjete dhe materiale bujqësore, trajnimi dhe këshillimi i të	Informimi i të ketyre personave për mundësitë e përfitimit të granteve bujqësore;	Numri i të riadhesuarve dhe te huajve që kanë përfituar grante bujqësore	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural/ Komuna	ZKKK AZHBR/MBZHR Drejtoria përkatëse komunale	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK me të dhënat për rastet kur përfitues të granteve janë personat e

	riatdhesuarve dhe te huajve në zonat rurale;	Përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve si përfitues i granteve bujqësore;			Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			riatdhesuar
Objektivi specifik 4			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
Avancimi i sistemit për ri integrim dhe integrim të mirëqenjes sociale të personave të riatdhesuar dhe te huajve			Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitim nga shërbimet sociale;			40 %	75%	90%
			Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve përfitues të asistencës sociale;			50%	70%	90%
			Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj në nevojë që kanë pranuar trajtim psiko-social;			%	30%	50%
			Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj të përfshirë në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative ;			10 %	30%	60%
			Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që u është siguruar banim i qëndrueshëm nga komunat (pas periudhës 12 mujore);			10%	30%	50%
			Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që kanë përfituar asistencë në sigurimin e kushteve për banim;			30%	50%	60%
#	Masa	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afatet kohore	Mjetet e verifikimit
4.1	Informimi dhe këshillimi social i personave të riatdhesuar dhe te huajve për mundësitë e përfshirjes në skemat sociale;;	Prano në zyre personin e riatdhesuar apo te huaj, te referuar nga ZKKK; Informo atë për shërbimet dhe	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve që u ofrohet këshillë për shërbimet dhe skemat sociale; Numri i rasteve që monitorohen derisa	QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Kordinatori Rajonal) ZP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatave	/	Në vazhdimësi	Raportet nga QPS Raportet e ZKKK

		skemat sociale; Këshilloje atë për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për përfshirje sociale; Menaxho rastin deri ne vendosjen ne sistemin social; Regjistroi ne bazën e te dhenave (SNS) rastin/skemën e përfitimi;	vendosen në sistemin social Vendosja e të dhënave për të riatdhesuarit dhe te huajt që përfitojnë nga skemat sociale në SMR		veKKRndore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
4.2	Asistimi i personave të riatdhesuar dhe te huaj në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.	Të përfshihet zyra e gjendjes civile si pjesë e KKR-së. Asisto personat e riatdhesuar dhe personat e huaj për sigurimin e dokumenteve te nevojshme për aplikim skemat sociale si dhe ndihma juridike falas Menaxho dhe monitoro rastin në shqyrtimin e kërkesës dhe vendimin përfundimtar; Regjistroi ne SMR	Vendimi i KKR-së plotësuar dhe ndryshuar nga komuna Numri i personave të riatdhesuar dhe te huajve që asistohen për përgaditje të dokumentacionit për aplikim në skemat sociale dhe ndihme juridike falas Numri i rasteve të monitoruara deri në shqyrtim të kërkesës deri te vendimi përfundimtar Vendosja e të dhënave për numrin e të riatdhesuarve dhe te huajve që	Komuna KKR QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) ZP Drejtoritë përkatëse komunale Agjensioni për ndihmë juridike falas	/	Në vazhdimësi	Raportet nga QPS Raportet e ZKKK

		rastin/skemën e përfitimit;	përfitojnë nga skemat sociale në SMR					
4.3	Sigurimi i banimit të qëndrueshëm	Monitoro rastet që janë të akomoduar me qera nga programi i ri integritetit dhe i integritetit Këshillo dhe ndihmo rastet ne nevojë për aplikim për banim social Siguro banim të qëndrueshëm pas skadimit të qirasë Regjistro në SMR rastin e përfitimit	Numri i rasteve të monitoruara Numri i rasteve të asistuar për aplikim për banim social Numri i rasteve që u sigurohet banim i qëndrueshëm Të dhënat në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)	QPS Drejtoritë përkatëse komunale Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integritetin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK për numrin e të riatdhesuarve që kanë përfituar banim të qëndrueshëm

4.4	Trajtimi psikologjik dhe asistenca psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te huaj në nevojë;	Identifikimi i rasteve dhe vlerësimi i nevojave për trajtim psiko-social Ofrimi i ndimës psiko-sociale për personat e identifikuar Monitorimi i rasteve që u ofrohet ndihmë psiko sociale Regjistrimi i të dhënave për rastet dhe formën e ndihmës psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te huajve Sigurimi i transportit për trajtim	Numri i rasteve të identifikuara në nevojë për ndihmë psiko-sociale Numri i rasteve që marrin ndihmë psiko sociale Numri i rasteve të monitoruara Numri i rasteve dhe të dhënave të regjistruara në SMR	ZKKK QPS	Qendra e shëndetit mendor Shkollat Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK për numrin e te riatdhesuarve që janë mbështetur dhe formën e ndihmës psiko sociale Raportet e Organizatave vendore dhe ndërkombëtare
4.5	Sigurimi i kushteve të banimit përmes renovimit, rindërtimit dhe mobilimit të shtëpive të personave të riatdhesuar dhe te huaj;	Këshillo personat e riatdhesuar dhe te huajt për mundësitë e përfitimit nga skema e renovimit, rindërtimit dhe mobilimit të shtëpive Ndihmo ata në kompletimin e dosjes për aplikim në këto skema	Numri i personave të riatdhesuar dhe te huaj që janë informuar dhe asistuar për mundësitë e përfitimit nga skema e renovimit, ndërtimit dhe mobilimit të shtëpive; Numri i rasteve/dosjeve të proceduara për shqyrtim në KKR; Numri i vendimeve të	KKR	ZKKK DRPRIH/MPB MMPHI Drejtoritë përkatëse komunale Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK Raportet e DRPRIH Të dhënat nga SMR

		Procedo dosjet për shqyrtim nga KKR Përcjelle lënden për ekzekutim ne DRPRIH përmes koordinatorit rajonal Regjistro rastin dhe vendos dosjen ne SMR	KKR për këtë skemë; Numri irasteve të përcjella në DRPRIH për ekzekutim; Vendosja e të dhënave në SMR për numrin e rasteve të aplikimit dhe vendimeve përfundimtare të përfitimit nga kjo skemë.					
4.6	Përfshirja (Informimi) e të kthyerve dhe te huajve në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative;	Informo dhe përfshij personat e riatdhesuar dhe te huaj në aktivitete kulturore, sociale, rekreative dhe inovative, te organizuara ne komunën tuaj Bashkëpunohet me organizatat për realizim te aktiviteteve te tilla ne komunën tuaj	Të dhënat mbi informimin e të riatdhesuarve dhe te huajve për përfshirje në aktivitete sociale dhe kulturore në nivel komunal Të dhënat mbi bashkëpunimin me organizata dhe projekte me qëllim përfshirjen e të riatdhesuarve dhe te huajve në aktivitete të ndryshme	ZKKK	DRPRIH/MPB Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Mediat	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
Objektivi specifik 5			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huajve në të sistemin edukativo arsimos			Numri i nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj të përfshirë në nivelin përkatës të shkollimit;			90%	100%	100%
			Numri i nxënësve që kanë vijuar kurset e gjuhës dhe mësimin plotësues;			50%	60%	85%
			Numri i rasteve të reagimeve të ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes;			50%	75%	80%

			Numri i programeve mësimore të rishikuara të shpërndara në shkolla;	10%	50%	80%		
			Numrin i të rriturve të riatdhesuar dhe te huaj, që kanë mësuar shkrim- lexim;	50%	60%	70%		
			Numri i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes në mësim;	80%	85%	95%		
#	Masa	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afatet kohore	Mjetet e verifikimit
5.1	Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në nivelin përkatës të shkollimit;	Merr infromatat nga ZKKK për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj që duhet të përfshihen në sistemin arsimor Vlerëso nivelin e njohurive te nxënësit te riatdhesuar dhe atyre te huaj Përcakto nivelin përkatës te shkollimit Akomodo nxënësit në klasat përkatëse	Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe atyre te huaj që janë përfshirë në sistemin arsimor Raportet e vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj Raportet e regjistrimit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj	DKA Shkollat	DRPRIH/MPB ZKKK QPS Shkollat Qendrat Mësimore Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë EPPRM (Ekipi për parandalimin dhe reagim për mosbraktisje)	/	Në vazhdimësi	Raportet nga DKA Raportet nga ZKKK
5.2	Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimi plotësues për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj;	Identifiko nxënësit që kanë vështirësi në përdorimin e gjuhëve zyrtare Organizo kurse të gjuhës në shkollën ne të cilën nxënësit vijnë në mësim;	Numri i nxënësve te kthyer ne komune; Numri i nxënësve të identifikuar me vështirësi ne përdorimin e gjuhëve zyrtare Numri i nxënësve që	DKA Shkolla përkatëse	DRPRIH/MPB ZKKK Shkollat Qendrat Mësimore Organizatave vendore dhe ndërkombëtare	/	Në vazhdimësi	Testet vlerësuese dhe raportet përkatëse

		Organizo mësimin plotësues bazuar në nevojat e nxënësit	kanë vijuar kurset dhe mësimin plotësues		me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
5.3	Nostrifikimi i dokumenteve të nxënësve të riatdhesuar dhe të huaj;	Nostrifiko dokumentet shkollore të nxënësve të kthyer dhe të huaj Ofro ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumentacionit të nevojshëm për nostrifikim	Numri i nxënësve që kanë nostrifikuar dokumente Numri i rasteve që u është ofruar ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumenteve	DKA MASHTI	DRPRIH/MPB Shkolla përkatëse Qendrat Mësimore Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportete e DKA për rastet e nostrifikimit të dokumenteve
5.4	Funksionalizimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes së shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe të huaj;	Organizo takime të rregullta me ekipet për parandalim dhe reagim kundër braktisjes së shkollave Diskuto për gjendjen e fëmijëve të riatdhesuar dhe të huaj, identifikoj fëmijët në rrezik për braktisje të shkollës Ndërmerr masa konkrete në bashkëpunim me prindërit dhe shkollën për parandalim të kësaj dukurie	Numri i takimeve të rregullta të ekipit për parandalim dhe reagim kundër braktisjes së shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe të huaj Të dhënat për aktivitetet dhe bashkëpunimin me prindërit dhe akterët tjerë	Shkollat DKA	KKR ZKKK Qendrat Mësimore Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë EPPRM (Ekipi për parandalimin dhe reagim për mosbraktisje)	/	Në vazhdimësi	Raportet nga Shkolat dhe DKA

		Përgatit raporte të rregullta dhe ndaj atome MASHTI dhe DRPRIH						
5.5	Hartimi dhe zbatimi i planeve të riintegritit dhe te integritit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj në arsim, bazuar në nevojat e tyre;	Vlerësimi i njohurive arsimore të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj Identifikimi i nevojave për mësim plotësues për nxënësit e riatdhesuar dhe te huaj Hartimi i planeve individuale për integrim në arsim të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj	Numri i rasteve të vlerësimit të njohurive arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj Të dhënat për mësim plotësues për nxënësit e riatdhesuar dhe te huaj Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj për të cilët janë hartuar planet individuale për integrim në sistemin arsimor	Shkolla DKA	DRPRIH/MPB ZKKK QPS Qendrat Mësimore Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegritin dhe integritin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet nga shkollat
5.6	Zhdukja e analfabetizmit të personave të riatdhesuar dhe te huaj; Organizimi i mësimi plotësues për familjet e riatdhesuara	Identifiko personat e riatdhesuar dhe te huaj që nuk dijnë shkrim – lexim Dërgo listën në DRPRIH përmes koordinatorëve rajonal	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve analfabetë; Masat e ndërmarra për zhdukje të analfabetizmit tek të riatdhesuarit dhe te huajt;	ZKKK DRPRIH/MPB	DKA QPS MASHTI Shkollat Qendrat Mësimore Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegritin dhe integritin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK Raprotete e DRPRIH

5.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikave të përfshirjes në shkollim për të riatdhesuarit dhe te huajt;	Monitoro rregullisht përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në shkollim Vlerëso zbatimin e politikave të përfshirjes së fëmijëve të shkollim Përgatit raport te monitorimit dhe përcjell nga një kopje ne MASHT dhe DRPRIH	Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në sistemin arsimor të Kosovës	DKA	MASHTI DRPRIH/MPB ZKKK Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e DKA Raportet e ZKKK
Objektivi specifik 6			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
Integrimi social dhe informimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, si dhe komunitetit pritës			- Numri i takimeve të grupeve të organizuara me të kthyerit në komuna për ndarjen e eksperiencave dhe vendosjen e rrjeteve në komunitet; - Numri i aktiviteteve për promovimin e procesit të riintegrit;			5%	30%	60%
						5 %	40%	70%
Nr.	Aktiviteti	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkras	Kosto financiare	Afatet kohore	Mjetet e verifikimit
6.1	Organizimi i takimeve me të riatdhesuarit dhe te huajt për ndarjen e eksperiencave dhe vendosjen e rrjeteve në	Organizo takime informative me te riatdhesuarit dhe te huajt; Diskuto ne këto takime me te riatdhesuarit që kanë	Numri i takimeve të organizuara me të riatdhesuarit dhe te huajt dhe komunitetin në nivel komunal	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK ve për takimet e organizuara dhe numri i pjesëmarrësve

	komunitet;	histori për te ndare me te tjerët, për ndarjen e përvojave me te riatdhesuar tjerë			riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
6.2	Ndarja e përvojave e personave të riatdhesuar dhe te huaj gjatë procesit të integritit përmes realizimit te aktiviteteve të ndryshme;	Organizo takime/ debate dhe përfshij të riatdhesuarit dhe te huajt të ndajnë historitë e tyre të migracionit me persona tjerë nga komuniteti i komunës tuaj, si mase e parandalimit të migrimit ilegal	Numri i takimeve të organizuara dhe përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve me qëllim të ndarjes së përvojës dhe parandalim të migrimit ilegal	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK nga takimet/debatet e organizuara
6.3	Promovimi i procesit të ri integritit dhe integritit përmes informimit publik;	Promovo procesin e ri integritit dhe integritit ne komunën tuaj, përmes diskutimeve publike në radiot dhe televizionet lokale	Numri i artikujve dhe storjeve në mjetet e komunikimit (Radio, TV, Internet dhe media sociale)	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet dhe referencat nga komunikmi masiv
Objektivi specifik 7			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
Koordinimi ndërmjet akterëve lokal të përfshirë në procesin e riintegritit te riatdhesuarve dhe integritit të të huajve			• Është vendosur praktika e bashkëveprimit horizontal në nivel lokal dhe ajo është efektive; • Është avancuar bashkëveprimi ndërmjet ZKKK dhe QPS; • Është avancuar bashkëveprimi ndërmjet akterëve në nivel qendror dhe atyre lokal të kyçur në riintegrim dhe integrim;			40%	60%	80%
						30%	50%	80%
						50%	70%	80%

			• Është avancuar bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile, projektet dhe organizatat ndërkombëtare;			40%	60%	70%
Nr.	Aktiviteti	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afati kohor	Mjetet e verifikimit
7.1	Vendosja e kontakteve me të gjitha institucionet relevante dhe organizatat;	Krijo një bazë të dhënave (listë) me kontakte të institucioneve dhe organizatave që fushën e riintegritit dhe integritit të personave të riatdhesuar dhe te te huajve në komunë/rajon Vendos kontakte te komunikimit dhe bashkëpunimit	Janë identifikuar organizatat dhe akterët që punojnë në fushën e riintegritit dhe integritit te personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj në komunë/rajon Kontaktet me akterë dhe organizata janë vendosur	ZKKK	QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegritin dhe integritimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e punë dhe bashkëpunimit me partnerë
7.2	Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet drejtorive komunale dhe gjithë akterëve të përfshirë në nivel lokal;	Organizo takime te rregullta mujore me drejtorit relevante ne komunën tuaj, diskuto për nevojat dhe mbarëvajtjen e procesit te ri integritit dhe integritit Se paku një herë në tremuaj organizo takime me te gjithë akterët e ri integritit dhe integritit ne nivelin lokal	Numri i takimeve dhe Raportet nga takimet me drejtoritë relevante për riintegritim dhe integritim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj Raportet nga takimet me akterët tjerë relevant	KKR ZKKK	ZP QPS QAP Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Policia në komunitet Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegritin dhe integritimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

7.3	Ndarja e raporteve analitike dhe informatave relevante me të gjithë akterët e përfshirë në procese;	Ndaj raportet e rregullta me të gjitha drejtorit komunale, relevante ne ri integrim dhe integrim. Kërko dhe dërgo informata kthyesë, për rastet e referuara ne drejtorit përkatëse	Shpërndarja e raporteve me drejtoritë relevante dhe partnerët tjerë Të dhënat dhe raportet e pranuar nga drejtoritë përkatëse	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Policia në komunitet Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
Objektivi specifik: 8			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
<i>Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike ne nivel të komunës për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve</i>			<i>Rritja e nivelit të përfitimit nga donatorët që mbështesin riintegrimin në nivel dhe lokal;</i> <i>Numri i projekt-propozimeve të zhvilluara dhe të financuara nga donatorët e huaj;</i> <i>Rritet numri i projekteve të realizuara;</i> <i>Vendosja e mekanizmit adekuat për koordinim të asistencës teknike dhe donacioneve bazuar në prioritetet e strategjisë;</i> <i>Projektet dhe iniciativat që mbështesin fushën e riintegrimin monitorohen vazhdimisht;</i>			40%	60%	80%
						%	30%	50%
						%	30%	50%
						30%		
						%	50%	70%
							30%	40%
#	Aktiviteti	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkatës	Kosto financiare	Afati kohor	Mjetet e verifikimit
8.1	Identifikimi dhe sigurimi i kontakteve me të gjitha projektet e ri integrimin dhe integrimin;	Identifiko projektet e ri integrimin dhe integrimin ne komunën tuaj Siguro kontaktet e organizatave që	Të dhënat për projektet që realizohen në komunën/rajonin tuaj	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatrat vendore dhe	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		zbatojnë projekte të ri integrimit dhe integrimit në komunën tuaj			ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
8.2	Vendosja e sistemit për bashkëpunim dhe koordinimin e projekteve të ri integrimit dhe integrimit me përfaqësuesit e organizatave donatore dhe ofruesit e shërbimeve;	Krijo një data bazë me të gjitha projektet e ri integrimit dhe integrimit ne komunën tuaj dhe organizatave qe implementojne ato Organizo takime te rregullta, se paku çdo tre muaj, me organizatat që zbatojnë projekte të ri integrimit dhe integrimit në komunën tuaj Koordino aktivitetet ndërmjet organizatave, shmang dyfishimin e shërbimeve të njëjta dhe adresoj zbrastërit përmes projekteve Refero rastet ne nevojë te organizatat sipas profilit dhe shërbimeve qe ofrojnë	Raport mbi projektet që zbatohen në fushën e riintegritimit dhe integrimit në komunën/rajonin tuaj; Numri i takimeve koordinuese me projektet në komunën/rajonin tuaj	ZKKK	DRPRIH/MPB ZP Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.3	Identifikimi i nevojave të nivelit lokal për projekte në fushën e ri	Identifiko nevojat për projekte në fushën e riintegritimit dhe integrimit në	Nevojat për riintegrim dhe integrimit janë identifikuar dhe oporganizatat janë	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

	integritet dhe integritet;	komunën tuaj Informo organizatat dhe donatorët për nevojat tuaja	informuar dhe ftuar për bashkëpunim		komunale DRPRIH/MPB Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
8.4	Avancimi i sistemit të shkëmbimit të informatave me donatorët në nivelin lokal;	Organizo takime me donatorët në komunën tuaj, së paku një herë në vit Prezanto në këto takime nevojat e komune tuaj për donacione në fushën e ri integritet dhe integritet Ndaj informata relevante me donatorët në komunën tuaj	Raporti nga takimet me donatorët; Ndarja e informatave relevante për riintegrim dhe integritet me donatorët dhe partnerët në komunë/rajon	ZKKK	DRPRIH/MPB Drejtoria përkatëse komunale Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.5	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe asistencës teknike;	Organizo takime për diskutim të mbarëvajtjes së projekteve Kërko raporte të rregullta nga organizatat për zbatimin e projekteve të ri integritet dhe integritet në komunën tuaj Vlerëso zbatimin e projekteve dhe	Numri i takimeve me organizatat, projekte dhe donatorët; Raportet e organizatave për zbatim të projekteve Vlerësimi i ndikimit të projekteve në nevojat e	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		ndikimin e tyre në adresim të nevojave të komunës dhe ose të personave të riatdhesuar apo te huaj	komunës për riintegrim dhe integrim të personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj					
Objektivi specifik: 9			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
<i>Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira të procesit të riintegrit të personave të riatdhesuar dhe itegritit të të huajve</i>			- Janë fuqizuar kapacitetet e stafit të angazhuar për zbatimin e qasjes së bazuar në nevoja dhe trajtimin e grupeve të cënueshme - Numri i stafit të riintegritit dhe integritit të trajnuar për identifikimin, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve; - Numri i stafit relevant të trajnuar për menaxhimin e kualitetit të shërbimeve; - Numri i aktiviteteve të realizuara në nivelin lokal për shpërndarjen e praktikave të mira komunale			20%	50%	70%
						20%	50%	70%
						20%	50%	70%
						20%	50%	70 %
#	Aktiviteti	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afati kohor	Mjetet e verifikimit
9.1	Pjesëmarrja aktive ne trajnimet e organizuara për ri integrim dhe integrim;	Merr pjese aktive në trajnimet e organizuara nga DRPRIH, Organizatat ndërkombëtare apo Organizatat vendore	Numri dhe tema e trajnimeve të ndjekura	ZKKK	DRPRIH/MPB KKR Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga trajnimet
9.2	Shkëmbimi i përvojave	Punoni kohë pas kohe bashkërisht me	Numri i takimeve me homologët	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga takimet

	ndërmjet akterëve lokal përmes punës së përbashkët në teren;	homologet tuaj në komunat tjera, shkëmbeni përvojat dhe praktikak e mira, mësoni nga njëri tjetri për trajtimin e rasteve specifike			ZP Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
9.3	Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet komunave për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira;	Organizoni takime të përbashkëta me komunat e regjionit tuaj por edhe me komuna tjera Diskutoni për temat me interes në fushën e ri integritit Adaptoni përvojat dhe praktikak e mira të komunës përkatëse	Numri i takimeve të përbashkëta dhe temat e diskutuara	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP QPS Qendrat e shëndetit mendor Qendrat mësimore Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga trajnimet
Objektivi specifik: 10			Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025
Monitorimi sistematik i qasjes së orientuar në nevoja për secilin kategori të personave të riatdhesuar dhe të huaj, bazuar në planin individual të riintegritit dhe integritit			- Numri i stafit të trajnuar në fushën e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të pakove standarde të riintegritit dhe integritit; - Numri i stafit relevant të trajnuar për menaxhimin e kualitetit të shërbimeve; - Numri i stafit relevant të trajnuar për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut;			%	30%	60%
#	Aktiviteti	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afati kohor	Mjetet e verifikimit
10.1	Rritja e kualitetit të shënimeve në Sistemin elektronik të	Regjistro të gjitha rastet në SMR; Skano të gjithë	Nr i rasteve të regjistruara në SMR	ZKKK	DRPRIH/MPB	MPB	Në vazhdimësi	SMR

	Menaxhimit të Rasteve (SMR);	dokumentacionin për secilin rast individual dhe vendose në SMR Sigurohu që shënimet janë të sakta dhe të plota, për secilin rast	Nr dhe lloji i dokumenteve të vendosura në SMR Nr i përmirësimeve dhe plotësimeve në SMR					
10.2	Monitorimi sistematik i shfrytëzimit dhe ndikimit të shërbimeve në ri integrim dhe integrim të qëndrueshëm;	Monitoro rastet e regjistruara në SMR, nëse kanë marr shërbimet e nevojshme dhe kanë parashtruar kërkesat, bazuar në nevojat e identifikuar në FVN Kërko informata nga DKA nëse fëmijët e kthyer janë duke vijuar mësimin Siguro informata nga ZP nëse te kthyerit janë regjistruar ne ZP si punëkërkes dhe a janë qasur në skemat adekuate Kontakto të kthyerit dhe te huajt qe nuk kanë përfituar nga shërbimet Siguro informata nga menaxheret e rasteve	Të dhënat për rastet e monitoruara Raporte të rregullta për rastet e monitoruara	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	SMR Raportet nga tereni Raportet e ZKKK

		për ndikimin e skemave në riintegrim dhe integrim të qëndrueshëm						
10.3	Vendosja e një mekanizmi për monitorimin dhe raportim të komunave për zbatimin e Planeve Komunale të Ri integritetit dhe integritetit të qëndrueshëm.	Raportimi të DRPRIH për zbatim të planit Raportimi të MAPL Për zbatim të planit	Mekanizmi për monitorim dhe raportim të zbatimit të planit komunal për riintegrim dhe integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe te huaj	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale MAPL DRPRIH/MPB QPS ZP Organizatrat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Në vazhdimësi	Raporti i zbatimit të planit komunal



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Datë/a:	19.09.2023
Për/To/Za:	Kuvendin Komunal Deçan – z. Hajdar Sutaj, Kryesues
Nga/From/Od:	Znj. Dafina Cacaj – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
Përmes/Through:	Z. Bashkim Ramosaj – Kryetar i Komunës
Tema/Subject/Subjekat:	Kërkesë për rialokim të mjeteve kapitale në kategorinë e kapitalëve

Të nderuar,

Bzauar në LIGJIN NR. 08/L-193 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023 /neni 16 pika 1. për ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve, andaj kërkojmë nga ju që të aprovoni rialokimin e mjeteve financiare të kategorisë kapitale pasi që të njëjtat nuk kemi mundur t'i shfrytëzojmë në vitin 2023 dhe kërkojmë që të rialokohen për projektin kapital si më poshtë:


Mjetet financiare nga projekti ekzistues "Ndërtimi i Fshatit Turistik Laku i Kryqes, faza e II" kod 10/631/18015/32000/52838/045 në vlerën prej 100,000.00 € nga Grandi i Përgjithshëm. Të alokohen në projektin ekzistues "Zgjerimi i Ndriçimit Eficient publik nëpër fshatrat Baballoq, Shaptej, Dubovik, Papiq, Maznik, Dashinoc" kod 10/631/18015/31510/53202/0451

Arsyeshmëria: Projekti "Ndërtimi i Fshatit Turistik Laku i Kryqes, faza e II" është planifikuar 100,000.00 € për këtë vit mirëpo nuk kemi mundur të zhvillojmë procedura të tenderimit për shkak se nuk e kemi gati projektin për këtë fshat andaj këto mjete janë të lira dhe kërkoj nga ju që t'i aprovoni, t'i orientojmë në projektin ekzistues "Zgjerimi i Ndriçimit Eficient publik nëpër fshatrat Baballoq, Shaptej, Dubovik, Papiq, Maznik, Dashinoc" (ndriçimi publik i rrugëve) i cili ka vlerë prej 1,204.60 €.

Të bashkëngjitur gjeni kontratën e cekur më lartë.

Shpresoj në mirëkuptimin e juaj!


Me respekt,





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
631-22-7817-2-1-1/C197

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

JAVNA RAZSVETLJAVA d.d Branch in Kosovo, Rr.Beslidhja Prishtine, Prishtine, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Shërbime të Energjisë sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV (ME) NR.06 2021 PËR SHËRBIMET E ENERGJISË (ESCO) me numër identifikues: 631-22-7817-2-1-1 me nr. të bren. 631 22 035 211.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Shërbime të Energjisë sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV (ME) NR.06 2021 PËR SHËRBIMET E ENERGJISË (ESCO)

Nr.	Grupi
1	Shërbime të Energjisë sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV (ME) NR.06 2021 PËR SHËRBIMET E ENERGJISË (ESCO)

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]


1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë(in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Ramosaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	09.11.2022
Vula:	




[Ne rast te kontratave me vlere te madhe]

Emri:	Bashkim Ramosaj
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	09.11.2022
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Arman Koritnik
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	09.11.2022
Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofruesi i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson

realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien e kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruar ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të komunës dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,



Isah RUDAKU
Zv. Drejtor Departamenti Ligjor

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Rr. "Ukshin Hoti" Nr.120 Kompleksi "Ramiz Sadiku"
10000 Prishtinë, Kosovë



Email: isah.rudaku@rks-gov.net
Tel: +383 (0) 38 200 38 478
Mob. +383 44 156-306
[www. .mbpzhr-ks.net](http://www.mbpzhr-ks.net)



Asambleja
01.Nr.VII
Deçan,dt.31.07.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të, të rregullt të Kuvendit, me dt.31.07.2023.

Në mbledhje ishin prezent:22 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale (6), OSBE, OJQ.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimt Rinorë,
3. Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë;
4. Shqyrtimi i Planit të mobilitetit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i model rregullores për taksat komunale;
6. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës,
7. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar;
8. Shqyrtimi i Projekt – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave;
9. Shqyrtimi i Draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025;
10. Themelimi i Komisionit për ndarjen e bursave për student;
11. Përgjigjet e drejtorit të drejtorisë për Shërbime Publike në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit (të cilat dorëzohen me shkrim në Zyre të Kryesuesit deri me dt.27.07.2023);
12. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e VII-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 22 anëtarë të kuvendit (mungojnë: Armend Loshaj, Floriana Hulaj, Fekri Qufaj, Hyri Dobrunaj, Shkelqim Tolaj), në vazhdim kryesuesi e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë, pastaj ka thënë se është rekomandim i KPF-së, që pikat nr,3 dhe 4 të hiqen nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk janë paisë asamblistët me material për këto dy pika, si dhe ka propozuar që në të ndryshme të debatohet rreth raportit të Zyrtarit të pasurisë, të sjellë nga drejtoresha e drejtorisë për buxhet dhe financa, në vazhdim e ka hapë debatin rreth rendit të punës.

Yllarta Thaqi e ka ngritë si shqetësim çështjen e mungesës së ujit të pijes.

Albesa Cacaj- ka kërkuar sqarim pse nuk ka ardhë për shqyrtim në Kuvend Plani për barazi gjinore, i cili ka qenë në plan të punës së kuvendit në muajin mars.

Kryesuesi- sqaron se hartuesja e Planit për barazi gjinore, Ajne Ibëhysaj ka pasë rast vdekje dhe nuk ka pasë mundësi që ta përgaditë planin, por në muajin shtator do të vjen për shqyrtim ky plan, pastaj e qiti në votim rendin e punës pa pikat nr.3- Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë; dhe nr.4-Shqyrtimi i Planit të mobilitetit; me raportin e Zyrtarit të pasurisë, rend pune i cili miratohet njëzëri.

Kryesuesi pas miratimit të rendit të punës ka njoftuar se që nga muaji shtator seancat e kuvendit do të transmetohen live.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit Rinorë.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fillimisht fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Leonora Ukëhajdaraj, si propozuese e këtij plani.

Drejtoresha ka sqaruar se kemi planifikuar që së pari të miratohet Plani e pastaj të themelohet KVRL, meqenëse vjen muaji i shtatorit dhe hapen shkollat e mundësitë për kontakte me të rinjtë janë më të mëdha, mirëpo shqetësim ka qenë dhe mbetet financimi i KVRL-së, ka thënë ajo.

Orges Tafilaj- pyet, qe sa kohë KVRL nuk është aktiv, si Plan ka thënë ai është mjaft i mirë, dhe çështja tjetër që dua ta ngris ka të bëjë me pagesën ku parashihen dy përgjegjës aktiv me orar të shkurtuar me pagë mujore 75 euro, mirëpo nuk besoj se kjo pagë duhet me mbetë kështu por duhet të rritet.

Drejtoresha përgjigjet që nga Prilli i vitit 2019 nuk ka KVRL.

Vatan Istrefaj- thotë se është obligim i juaji themelimi i KVRL dhe financimi mos të mbetet vetëm në letër por të bëhet ky financim, përndryshe plani si dokument është i mirë.

Arjan Dobraj- thotë se plani i përmbushë të gjitha kriteret që kërkohen për një plan të tillë dhe kërkon që në fshatra me qenë ma aktiv në këtë drejtim.

Miftar Ahmetxhekaj-thotë se plani e ka një obligim buxhetor, në vitin 2023 prej ku merren mjetet buxhetore.

Drejtoresha ka dhënë sqarime.

Mon Selmonaj- thotë, te titulli me çfar ka të bëjë kjo organizatë e rinisë nuk janë cekë të gjitha karakteristikat, kurse çka presin të rinjtë- ekzistojnë numri i veprimeve të ritë- kërkon sqarim, kërkon sqarim te KVRL si këshilltare e kryetarit, te buxheti ku ka të bëjë me pagesën ku parashihen dy përgjegjës aktiv me orar të shkurtuar me pagë mujore 75 euro, është shifër pa kuptim 75 euro, mendoj se aty duhet të jetë dikush përgjegjës por jo të paguhet në këtë shumë. Analizat te zonat rurale- nuk e di sa është reale kjo organizatë të monitoron shkollat, a është e qëlluar kjo, Analizat e nivelit të rinjve në komunën tonë në zonat rurale –këtu mendoj se duhet të punohet ma shumë, poashtu ai kërkon që Buxheti për mbështetje të planit për vitet 2024-2026 duhet të planifikohet dhe miratohet me buxhet komunal.

Faton Selmanaj- pyet, çka ka ndodhë me zyrën e KVRL-së dhe me paisjet e tyre që kanë qenë në zyrë.

Drejtoresha përgjigjet se zyra ku kanë vepruar KVRL shfrytëzohet nga dikush tjetër kurse paisjet janë dhe ruhen në një zyrë tjetër.

Meqenëse nuk kishte diskutime tjera , Kryesuesi e qiti në votim në parim, asamblistët e miratojnë me 17 vota për dhe 5 abstenim. Miratohet Plani Lokal i Veprimit Rinorë dhe i njëjti i nënshtrohet procedurës së konsultimit publik.

Pikat III dhe IV janë hjekë nga rendi i ditës.

V. Shqyrtimi dhe miratimi i model rregullores për taksat komunale;

Kryesuesi- e ka prezentu model rregulloren për taksat komunale pastaj fjalën ia ka dhënë Yllarta Thaqi, Kryesuese e komisionit për hartimin dhe përpunimin e model rregullores.

Yllarta Thaqi, kryesuese e komisionit- ka thënë se si komision kanë punuar mjaft në përgaditjen dhe harmonizimin e kësaj model rregullore, komisioni ka qenë i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike në kuvend, me përjashtim të LDK-së të cilët nuk e kanë sjellë emrin e përfaqësuesit të vet në komision, model rregullorja ka thënë ajo ka dalë edhe në diskutim publik dhe tani është verzioni final, mirëpo si komision kemi qenë të pasigurtë te një tarifë në drejtorinë për shërbime Publike- Vërtetimi për shërbim ushtarak, për të cilin kërkon sqarim nga drejtori- a është e nevojshme ende të mbetet kjo tarifë apo duhet të hiqet nga rregullorja kjo tarifë bashkë me lëshimin e atij vërtetimi.

Miftar Ahmetxhekaj-thotë, kërkoj falje që si grup nuk e kemi përfaqësuesin tonë në komision, ndërsa sa i përket rregullores kur ka të bëjë me masat e ndërmarra te ujrat e zeza, si ki mi trajtu këtë çështje ti kur nuk ki fare kanalizim të ujrave të zeza në fshatrat anej bistrice, ndërsa te zonat, zona e dytë dhe e treta dallimet në tarifa nuk janë të harmonizuara dhe kjo gjë duhet të bëhet.

Drejtori, Izet Zenuni- sqaron se tarifa- vërtetim për shërbim ushtarak, duhet të mbetet në rregullore sepse ende ka kërkesa për një dokument të tillë, si për shembëll kërkohet si vërtetim 5-6 herë në vit nga bashkatdhetarët tanë në Kanada dhe vërtetimi lëshohet me dy dëshmitarë të personit që e kërkon. Kryesuesi- e qiti në votim, meqenëse nuk kishte të interesuar tjerë për debat, antarët e kuvendit njëzëri e miratojnë Rregulloren për taksat komunale (22 prezent në sallë).

VI.Raporti i Kryetarit.

Kryesuesi- e ka prezentu raportin gjashtë mujor të punës së kryetarit të komunës, pastaj e ka hapë debatin rreth këtij raporti.

Vatan Istrefaj-ka thënë se materiali është mjaft voluminoz, vlenë të theksohet se ky raport ka të bëjë me punën që lidhet drejt për drejt me qytetarin, ka thënë se është cekë në raport se janë nënshkru 13 kontrata gjë që është mirë, mirëpo ende ka fshatra që nuk kanë ujë të pijes 24 orë si dhe rrugët kanë mbete ashtu si kanë qenë të parregulluara dhe këto janë gjana elementare për jetë.

Orges Tafilaj-kërkon që te mediat gjendja të paraqitet mirë dhe drejt, në vazhdim ka shtruar pyetjen në fq.12 vlera e motorrave Atv 6x6 dhe pjesëve shtesë çka është dhe ka kërkuar sqarim për të, ndërsa si lajm i mirë thotë se është punimi i draftit final të hartës Zonale sepse janë kërku për një kohë të gjatë hartimi i tyre, te shëndetësia i falënderojmë stafin për punën e mirë që e bëjnë dhe qasjen që kanë ndaj qytetarëve, te arsimi- rezultatet e nxënësve vërtetë janë për tu duartrokitë.

Mifar Ahmetxhekaj-thotë se ne këtu sot po flasim për raportin e punës së kryetarit, jo për veprimet procedurale të administratës sepse janë të panevojshme për shembëll futja në raport e vendimeve për pushim vjetor, janë veprime procedurale që janë ligjore, janë të vazhdueshme dhe kanë qenë të panevojshme të përfshihen në raport .

Yllarta Thaqi- thotë se raporti në pjesën e parë është mjaft i mirë ndërsa ka thënë se nuk duhet të përfshihen në raport emrat e individëve, ka pyet kush është zyrtar për mbledhje të detyrueshme në tatim në pronë.Te shëndetësia paisja me aparaturë të gjinekologjisë ka qenë mjaft e nevojshme dhe ju përgëzoj, vazhdoni ju me punu dhe ne na kini pas ka përfunduar ajo.

Faton Selmanaj- te shërbimet publike ka cekë- kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Dranoc dhe nuk di si pu jetojke aty nga ky kanalizimim, pyetja ime është, çka po ndodhë me impiantin në fshatin Dranoc.

Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj-përgjigjet në çështjet e ngritura dhe pyetjet e shtruara nga asamblistët, sa i përket pyetjes rreth furnizimit me ujë të pijes, ai ka thënë se ju e dini që uji i pijes nuk është kompetencë komunale por është kompetencë e KRU që nuk na përgjigjet neve, nuk jemi përgjegjës për ujin e pijes por nuk jemi përgjegjës as nuk menaxhojmë edhe me ujin për vaditje të tokës, sa ju përket rrugëve, ne kemi pasë një marrëveshje me ministrinë për Llotin nr.3, kemi fillu në Dubravë, Shaptej dhe kemi me vazhdu në Strellc dhe sa kemi me arrite me punu nuk di sepse varet edhe nga përkrahja e ministrisë, për Orgesin përgjigje për pyetjen e shtruar për motorra, i kemi ble 30 biqikleta poashtu edhe paisje të tjera të kërkim shpëtimit për shtigjet malore sepse janë shënu shtigjet në bjeshkë dhe unë i falënderoj publikisht ata që kanë punu në këtë drejtim (Drejtoria ekonomisë) mirëpo hala jemi në fazën e promovimit të turizmit edhe pse i kemi ble këto paisje(edhe motorrat), Kryetari ka thënë se e kemi një fond nga shteti Italian në shumën prej 1 mil e 800 mi euro, fond i cili është për promovimin e turizmit malor për Komunitat Deçan, Pejë, Junik. Te aktet administrative(përgjigje për Miftarin) jemi pjesë e matjes së performancës sepse nëse nuk përputhen këto të dhëna gjatë monitorimit të komunës nuk po vlerësohet me pikë fare atëherë. Për Yllarten-Zyrtar për mbledhje të detyrueshme në tatim në pronë, është zyrtari në tatim në pronë sepse mund të dënohemi për mos respektim të afatit, për Fatonin (impianti në fshatin Dranoc) nuk kemi mujtë me i pagu shpenzimet e rregullimit të impiantit nga buxheti komunal sepse është projekt që kushton shumë, aty duhet mu vendosë edhe një trafo nga KEDS dhe krejt ky aktivitet ka mu krye deri në shtator.

Albesa Cacaj- fq.92 pika 23 ku thotë se është projekt në gjashtë mujorin e dytë të vitit, dhe pyetja ime këtu është kurë kanë me fillu punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve për në Bjeshkë të madhe, për të cilën kryetari përgjigjet se nuk kanë me fillu këtë vit.

Kryesuesi e mbylli debatin rreth raportit të punës gjashtë mujore të kryetarit të komunës.

VII. Raporti 6 mujor financiar.

Kryesuesi e prezentoj raportin 6 mujor financiar pastaj e hapi debatin rreth tij.

Mon Selmonaj te vendimet gjyqësore- për 6 muaj 55 vendime, kryetari në një takim të mëhershëm ka thënë se kanë përfunduar kontratat në vepër, kurse këtu po vjen raporti me dhjetëra e dhjetëra emra ku tregon se po paguhet ata puntorë me kontratë në vepër.

Miftar Ahmetxhekaj- e kemi marrë raportin me shumë shpenzime të cilat unë i quaj shpenzime të kqia, siq janë subvencionet, karburantet, dreka zyrtare pagesa e puntorve me kontratë në vepër, shërbimet intelektuale- çka paguhet këtu, ku paguhet zyrtarët komunal, Te Higjiena- mirëmbajtja rutinore- pyetja ime çka është. Qeratë e banesave- a janë të nevojshme pagesat e këyre qerave dhe a keni marrëveshje paraprake për pagim të qeras së banesës dhe e fundit Veturat me qera cilat janë.

Drejtoresha e buxhetit, Dafina Cacaj- përgjigjet në pyetjet e shtruar, ajo thotë se vendimet gjyqësore –paga dhe mëditje (për Monin) janë shujtat e arsimit, kontratat për shërbime të veçanta, janë ato pagesa që janë borxhe të papaguara të kontratave të mëhershme, kurse kontrat tjera janë ndërpre, shërbimet intelektuale janë pagesat që bëhen për të gjitha komisionet e kuvendit dhe ekzekutivit që paguhet në këtë kod , te pagesat per qera –paguhet qera per familjet me nevojë që jetojnë me qera, Veturat me qera-janë veturat e kryetarit dhe nën kryetarit, tjerat makina janë të vjetra në pronësi të komunës. Mirëmbajtja rutinore është kontrata n'shpi që i paguajmë faturat që na i bjen Higjiena.

Orges Tafilaj-thotë se i kemi problemet e mëhershme te raporti. Te vendimet gjyqësore përmbartimore Raporti i auditorit ka me tregu se e keni dëmtu buxhetin prap sepse kryetari ka bërë premtime për investime kapitale dhe ndoshta ndonjë herë ka me hy në obligime pa e pasë buxhetin ose në bazë të një premtimi të ardhshëm por kompanitë nuk na presin dhe i kërkojnë mjetet e tyre, pagesat për karburante janë koxha të mëdha. Vërejtjetet e auditorit të kaluara duhet me i marrë parasyshtë dhe shumë seriozisht kur i bëjmë pagesat e shpenzimeve të ndryshme.

Albesa Cacaj-shpenzimet te zyra e kuvendit- 2000 euro te Petrol Kompani, pyet pse është bërë gjithë ky shpenzim dhe kërkon të ipet sqarimi.

Florim Mataj- u ngrit si shqetësim kontrata në vepër dhe shpenzime intelektuale, mirëpo në mungesë të stafit janë angazhu këta puntorë dhe unë po du me thane këta njerëz ta kryejn punën e vet si duhet. Meqenëse nuk kishte të tjerë të interesuar për debat, kryesuesi e mbylli debatin rreth raportit 6 mujorë të shpenzimeve.

VIII. Shqyrtimi i Projekt – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave.

Kryesuesi e prezentoj si pikë pastaj për sqarime fjalën ia kaloi drejtorit të Shërbimeve Publike.

Izet Zenuni, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, ka sqaruar se Projekt-rregullorja e prezentuar është Model rregullore e re e hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, kërkoj nga ju që sot ta kalojmë si dokument dhe bashkë ta përgadisim dhe ta harmonizojmë dokumentin final.

Albesa Cacaj- thotë se ne kemi mjaft rregullore të miratuara por është e rëndësishme që ato të zbatohen, jo vetëm formalisht mu miratu, sepse jemi lodhë tuj miratu rregullore që nuk po zbatohen.

Drejtori, Izet- thotë se rregullorja e parë për Menaxhimin e mbeturinave është miratuar në vitin 2019 dhe zbatohet 95%.

Yllarta Thaqi- si draft është tepër e mirë dhe ju përgëzoj.

Orges Tafilaj- pyetje, çka ka ndodhë me hapsirën e caktuar për deponi inerte e caktuar me vendim të kuvendit, fq.16. Parapagimi 10% për konsumatorët që paguajnë për një vit është në rregull, kurse 5% parapagim për 6 muaj se di a është në rregull dhe sa ka me pasë efekt dhe propozimi im është të hiqet 5%-shi komplet për 6 muaj në mënyrë që të mbetet 10% për një vit ose nëse rritet kjo prap ka me pasë një efekt të vogël. Dhe në fund një rekomandim i fundit për Komisionin e akcionerve mendoj se kur do që shikojnë në lidhje me proqesin të shiqohet asistencë komerciale e atyre landëve

Faton Selmanaj- te mbikëqyrja e inspektimeve janë disa hapsira publike që edhe pse pastrohet prap ndotet ambienti prandaj kërkoj që të ndërmerren hapa konkret nga inspekcioni.

Izet Zenuni- ka sqaruar te parapagimi 10% dhe te 5%, ai ka thënë se kemi parasyshtë këtë vërejtje dhe do ta shqyrtojmë, te deponitë ilegale që ne i pastrojmë vazhdimisht kjo ndodhë sepse është mungesë e deponisë ku mund ti hedhin mbeturinat dhe veprimeve të qytetarëve që i hedhin ato vend

e pa vend. Zingjiri i inspektionit funksionon por jo aq sa duhet sepse ne nuk e kemi një inspektor komunal për shërbime publike-është mungesë e vendosjes së gjobave.

Kryesuesi- thotë ta miratojmë në parim dhe tia hapim rrugën për shqyrtim, ndryshim dhe plotësim të mëtutjeshëm, pastaj e qiti në votim, Anëtarët e Kuvendit njëzëri(21 prezent) e miratojnë në parim, e njëjta i nënshtrohet procedurës së konsultimit publik.

IX. Shqyrtimi i Draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025.

Kryesuesi- e prezentoj Draft-Planin komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025, pastaj ka sqaruar se propozuesi i këtij Plani, Artan Ismajlaj nga ZLK, ka qenë prezent në KPF për të dhënë sqarime, por sot mungon për arsye familjare, andaj sot kërkoj nga ju që të kini mirëkuptim dhe ta shqyrtojmë dhe miratojmë në parim dhe meqenëse kërkohet të del si dokument në konsultim publik.

Miratohet në parim si dokument në leximin e parë dhe del në diskutim publik (miratimi bëhet me 14 vota pro).

X. Themelimi i Komisionit për ndarjen e bursave për student.

Kryesuesi- e prezentoj këtë pikë, pastaj sqaroj se komisioni duhet të përbëhet nga 7 anëtarë, 4 nga Asambleja, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 OJQ lokale. Në vazhdim propozohen kandidatët dhe formohet Komisioni për ndarjen e bursave për studentë në këtë përbërje: 4 anëtarë nga Asambleja, Lendita Berisha-AAK, Arjan Dobraj-AAK, Albesa Cacaj-LDK, Orges Tafilaj-LVV, dy nga Ekzekutivi, Manjolla Shala dhe Zeqë Malaj, një OJQ-Adem Lushaj.

Kjo përbërje e komisionit miratohet njëzëri.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim ka thënë se kërkohet që sot të formohet edhe komisioni për ankesa për ndarjen e bursave për student që sipas rregullores duhet të përbëhet nga 3 anëtarë, të dy këto komisione i raportojnë kuvendit për punën e tyre.

Poashtu formohet edhe komisioni për ankesa, i cili duhet të shqyrton ankesat studentëve që nuk është ndarë bursa për studentë, komisioni formohet në këtë përbërje: Dy nga Asambleja, Leotrim Hadergjona-AK dhe Vatan Istrefaj-LDK, një nga Ekzekutivi DKA, Besart Cacaj.

XI. Përgjigjet e drejtorit të drejtorisë për Shërbime Publike në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit (të cilat dorëzohen me shkrim në Zyre të Kryesuesit deri me dt.27.07.2023);

Kryesuesi e ka prezentu këtë pikë dhe pastaj e ka ftuar drejtorin, Izet për të dhënë sqarime.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Izet Zenuni, ka sqaruar se kanë ardhë dy pyetje me kërkesat e Vatan Istrefaj dhe Blinera Lokaj, pastaj përgjigjet se sa ju përket vendosjes së Shenjave të komunikacionit- është mungesë që nuk ka mujtë mu kry kjo punë por javën tjetër do të kryhen, te pyetja e Blinerës Ndriçimi publik në fshatin Sllup është nalë për shkak të pagesës, tash pagesa është krye dhe brenda jave lëshohet ndriçimi publik.

Në vazhdim drejtori përgjigjet në pyetjet e drejtuar me shkrim me të cilat është paisë kuvendi me material, si më poshtë.

1.Pyetja: Siç mund të i shikoni të gjitha rrugët lokale në Komunën e Deçanit janë bërë me rrezik për të lëvizur me vetura, për shkak të rritjes së drunjëve, degëve, therrave, e barishteve të cilat i kanë kapluar gjysmën e hapësirës së rrugëve.

Kjo i rrezikon edhe qytetarët që lëvizin këmbë, nxënësit etj, të cilët në mungesë të trotuareve i shfrytëzojnë rrugët për lëvizje.

Pyetja është se çfarë keni bërë si drejtori, për krasitjen dhe pastrimin e hapësirave anësore përgjatë gjitha rrugëve në Komunën e Deçanit ?

-Përgjigja e drejtorit - Pastroi rrugët dhe largimi i vegjetacionit, kjo punë fillon me 15 gusht.

2.Pyetja: Meqenëse Ndërmarrja “Higjiena” po funksionon jashtëzakonisht mirë, pse nuk i keni përfshirë në kuadër të kontratës “N’shipi” edhe pastrimin e mirëmbajtjen e varrezave në të gjitha fshatrat e komunës së Deçanit, e jo vetëm tri (siç janë të cekura në kontratën aktuale), përderisa menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje janë deklaruar se kanë kapacitete të mjaftueshme për ta kryer këtë shërbim ?

Dhe a keni mundësi ju lutem ta realizoni edhe këtë shërbim ndajë qytetarëve?

- Përgjigja e drejtorit-Te Ndërmarrja Higjiena që kërkohet që ta kryen pastrimin e varrezave, sqaron se kanë mu futë si pozicion te kontrata “N’shipi”, Mirëmbajtja e varrezave dhe heqja e vegjetacionit.

3.Pyetja;Meqenëse është shfaqur pengesë me caktimin e lokacionit aktual për deponin inerte, çfarë veprimesh keni marrë si drejtori që të zgjidheni këtë problem, dhe kur mendoni se do te jetë në funksion, në mos aty ku ishte planifikuar, në ndonjë lokacion adekuat për deponi inerte?

-Përgjigja e drejtorit - Lokacioni për deponi inerte- po është kthye vendimi negativ dhe kërkohet shfuqizim i atij vendimi, i cili do të bëhet sot.

4.Pyetja: Siç shihet gjithandej Deçani është kapluar me reklama të lloj llojshme dhe gjithandej publike e private, si e menaxhoni si drejtori këtë çështje?

A do te filloni verifikimin e vendosjes se reklamave, qoftë ato të operatoreve ekonomik (që kanë licenc nga komuna) qoftë atyre të bizneseve, apo individuale, për ti aplikuar kriteret e reklamave, llojet dhe madhësitë e tyre, qëllimin e përdorimit dhe pajisjen me leje?

- Përgjigja e drejtorit- Te reklammat, është shumë e drejtë, por do të caktohet një model i njëjtë për të gjitha reklammat që do të bëhen dhe kjo do të behet në momentin që miratohet Plani zhvillimor komunal.

5.Pyetja: Tashmë dihet që në udhëkryqet e rrugës “Elez Geci & Maxhun Berisha” konkretisht ne udhëkryqin tek fshati Llukë e Epërme dhe Pozharë numri i aksidenteve është i madhë, ne të dy vendet fatkeqësisht ka pasur edhe aksidente me fatalitet... pse nuk i vendoseni shenjat e komunikacionit (te cilat janë dëmtuar nga aksidentet dhe pengesat (policët e shtrirë) ne udhëkryqet kryesore të rrugës që të shpijnë nga Deçani ne Lumbardh, përkundër kërkesave te vazhdueshme të komunitetit? (arsyetimi qe nuk lejon ministria tanimë nuk qëndron sepse një pengës e tillë është vendosur nga Komuna vetëm për një familje në këtë pjesë).

- Përgjigja e drejtorit – sa i përket pyetjes, Vendosja e policëve të shtrirë, është bërë vendosja e policëve të shtrirë te kryqi i Pozharit, në një udhëkryq në fshatin Llukë afër një biznesi do të vendosen shpejt.

6.Pyetja:Është e domosdoshme vendosja e shenjave te komunikacionit dhe she njëzimi i rrugës, po ashtu ndonjë polic i shtri në fshatin Strelc i Ulet, rruga qe te lidhë me Lybeniq, udhekryqi te Lufaj dhe tjerë..? A e keni konstatuar këtë gjendje, dhe kur pritët të ketë veprime konkrete?

7. A keni ndërmarrë veprime konkrete për vendosjen e shenjave të komunikacionit ne të gjithë territorin e Deçanit?

-Shenjat lajmëruese në gjitha hyrjet e fshatrave me mbishkrimin e emrit te fshatit?

-Vendosja e shenja te komunikacionit ne qytet dhe fshatra që janë dëmtuar nga aksidentet (sepse përkundër premtimeve nuk kemi vërejtur qe ka përmirësim në këtë drejtim?

-Vendosjen e shenjave lajmëruese afër shkollave (p.sh. te shkolla e fshatit Strelc i Eperm, por edhe tek shkollat tjera), si dhe polic të shtrire në perimetrin afër shkollave??

-Përgjigja e drejtorit-Pengesat në trafik- rrethi te Ukaj dhe te lagja Lufaj në fshatin Strelc të Ulët do të vendosen (përgjigje për pyetjen e Vatanit).

8.Pyetja:A keni kontratë me ndonjë kompani për mirëmbajtje, që do ti kryente edhe shërbimin, si ç bllokimi i urave (gypave për ujitje, si rasti në fshatin Strelc i Eperem, tek Mahmudemjat, qe kalon rrugën kryesore) por edhe për vendosjen e shakteve, te cilat dëmtohen apo vjedhjen?

-Përgjigja e drejtorit- Po, Kemi kontratë me Higjienën.

9.Pyetja:Kur pritët të largohen këto trafot e KEDS-it te cilat janë të vendosura ne trotualet përgjatë rrugës kryesore nga Deçani deri ne Carrabreg?

-Përgjigja e drejtorit-Kemi shumë kërkesa për mu largu por nuk varen nga ne.

10.Pyetja:A keni bërë ndonjë plan, që trotualet rrugës së qendrës mos të parkohen në trotuar, pasi që qytetarët që lëvizin këmbë po detyrohen të ecin rrugës?

- Përgjigja e drejtorit-Ne i kemi vendosë shenjat, por është kompetencë e policisë dhe zyrtari për transport publik me i largu.

Miftar Ahmetxheka- pyet, a keni mundësi për këtë çështje mu koordinua me komandantin e policisë.

11.Pyetja: Si qëndron bashkëpunimi me KEDS-in për vendosjen e shtyllave të reja nga betoni, të transmetuesve të rrymës, në lokalitetet që nuk janë vendosur?

- Përgjigja e drejtorit- Afër 36 projekte KEDS i ka dorëzua në komunë për lëshimin e Pëlqimit, por kurë do të kryhen ata e dinë.

12.Pyetja:A e keni arritur të bëni zgjidhje për stacionin e autobusëve në rrugën kryesore që është rregulluar tani, në Isniq, pjesën tjetër të rrugës, faktikisht pasi të hysh në rrugën me katër korsi, që i bjen rruga nga Isniqi në drejtim të Deçanit?

- Përgjigja e drejtorit-Në momentin kurë vendoset shtresa e tretë e asfaltit do të vendoset edhe stacioni i autobusëve.

13.Pyetja: Hapësirat publike në qendër të Deçanit janë duke u keqpërdorur, rasti me i keq është tek lokalet ku është stacioni i autobusëve, që presin udhëtarët me shkua në drejtim të Pejës (stacioni përballë Postes) ajo pjesë e trotuarit publik shfrytëzohet me pa të drejt nga kafiterit dhe bizneset tjera, si tarasë apo vendosjen e gjerave afariste, ndërsa nxënësit dhe udhëtarët detyrohen të qëndrojnë në rrugë, madje ka ankesa nga qytetarët se familjarët e tyre dhe nxënësit detyrohen të shkojnë këmbë tek kanali për ta pritur autobusin vetëm të ju shmangen kontakteve me njerëz të shumtë që qëndrojnë të ulur me karrike e tavolina në vendin ku do të duhej të qëndronin ata që presin për të udhëtuar?

- Përgjigja e drejtorit- Në këtë pyetje u përgjigj kryetari dhe unë nuk kam çfarë shtoj më tepër.

14.Pyetja: Kur fillon projekti i elektrifikimit të fshatrave?

Për sa kohë përfundon?

Dhe si është planifikimi i punimeve, renditja e fshatrave në implementimin e projektit?

-Përgjigja e drejtorit-Është shqetësuese kjo- ato dalin në trotuarë, por vetëm një pjesë paguajnë qera.

15.Pyetja : Si është dinamika e punimeve në lotin 3, në cilat fshatra keni punuar, në cilat tjera këtë vit keni me filluar?

Pse nuk ka filluar projekti nga fshatrat me emrin e të cilave është emërtuar projekti dhe është votuar buxheti si i tillë: “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Strellc i Eperm, Strellc i Ulet, Llukë e Eperme, Dashinoc, etj” dhe kur do të filloni të realizuar punimet në këto fshatra, pasi që qytetarët janë në pritje, sepse e kanë shikuar dhe degjuar se vitin e kaluar Kuvendi i Komunës kështu e ka votuar buxhetin për këtë projekt?

-Përgjigja e drejtorit-Është projekt detal që është ka punohet dhe nuk dihet ende kostoja pastaj dihen edhe afatet kohore.Në qershor ka pasë me fillu porë është vonu, dhe fshati i parë që ka me fillua është Baballoqi, kjo punë fillon në muajin gusht, Te Lloti Nr.3 e tha edhe kryetari në raportin e punës.

Vatan Istrefaj- pyet, te policët e shtrirë- a ka mundësi me i vendosë shpejt apo vet qytetarët i vendosin.

Orges Tafilaj- për trafo pyet, a janë të vendosura në pronë komunale , për të cilën drejtori përgjigjet, po në pronë komunale janë të vendosura. Orgesi për ujë të pijes- në Elena Gjike janë një 10 shpi që nuk kanë ujë që tre muajt, pyetja ime është, çka do të ndërmerrni në këtë rast për këta qytetar.Drejtori përgjigjet se në ju bëjmë presion kompanisë, përndryshe nuk jemi kompetent për ujë të pijes.

Yllarta Thaqi- pyet rreth veprimeve që do të ndërmerr kompania që i ka bërë zbrastjen e ujit.

Vatan Istrefaj-sipas përgjigjeve që dha drejtori, asnjë zgjidhje për momentin nuk po shihet.

Meqenëse nuk kishte të interesuar të tjerë për diskutim, Kryesuesi e mbylli debatin rreth kësaj teme.

XII. Shqyrtimi i raportit të Zyrtarit për asete, e cila ka hyrë si pikë me kërkesën e Drejtoreshës së Drejtorisë për buxhet dhe Financa.

Kjo pikë njëzëri hiqet nga rendi i ditës, mbetet për të debatuar rreth saj në ndonjë nga mbledhjet e radhës.

XIII.Rishqyrtim i vendimeve të kuvendit me rekomandim të MAPL-së.

1.Shfuqizimi i Vendimit 01.Nr.XV-6 i datës 29.12.2022, për Caktimin e lokacionit për Deponi inerte (mbeturina të ngurta)Dhe,

2. Shfuqizimi i vendimit 01.Nr.IV-5/1 i dt.28.04.2023 për Caktimin e lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore.

Njësiri shfuqizohen dy vendimet (18 prezent).

SHFUQIZOHET VENDIMI 01.Nr.XV-6 i datës 29.12.2022, për Caktimin e lokacionit për Deponi inerte (mbeturina të ngurta), në Njësine kadastrale nr.P-70505078-00062-0, Zona Kadastrale Hulaj, dhe në Njësine kadastrale nr.P-70505021-00353-0, Zona Kadastrale Deçan, dhe

SHFUQIZOHET Vendimi 01.Nr.IV-5/1 i dt.28.04.2023 për Caktimin e lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore, i cili ka qenë i caktuar në parcelën nr.00542-0, me sipërfaqe 611 m², parcela nr.00545-0 me sipërfaqe 2303 m², parcela nr.00544-0 me sipërfaqe 716 m², parcela nr.00543-0 me sipërfaqe 771 m², parcela nr.00550-0 me sipërfaqe 6117 m² Njësia Kadastrale, Zona Kadastrale Deçan, e evidentuar si pronë komunale pronar-KOMUNA E DEÇANIT.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni

Kryesuesi i Kuvendit

Hajdar SUTAJ



Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.VII

Deçan, dt.28.07.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të të rregullt të KPF-së, me dt.28.07.2023.

Në mbledhje merrnin pjesë: 5 anëtar të KPF-së (mungojnë: Armend Loshaj dhe Hyri Dobrunaj), drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Leonora Ukëhajdaraj, drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj, zyrtari i ZKK-së, Artan Ismajlaj dhe Zyrtarja për informim, Edona Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit Rinorë,
3. Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë;
4. Shqyrtimi i Planit të mobilitetit;
5. Shqyrtimi i model rregullores për taksat komunale;
6. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës,
7. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar;
8. Shqyrtimi i Projekt – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave;
9. Shqyrtimi i Draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025;
10. Shqyrtimi i kërkesave,
11. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e shtatë të rregullt të KPF-së për vitin 2023, konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 5 anëtarë të KPF-së (mungojnë Armend Loshaj dhe Hyri Dobrunaj) dhe ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes pastaj e prezantoi rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij.

Faton Selmanaj- ka thënë se për pikat e rendit të ditës nr. 3 dhe 4 Nuk kemi material prandaj propozoj që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës ka thënë ai.

Vatan Istrefaj- thotë, edhe unë kam të njëjtin mendim me Fatonin, që pikat 3 dhe 4 mos të shqyrtohen sot, meqenëse nuk jemi paisë me material, si dhe te pika nr.10-Shqyrtimi i kërkesave nuk na ka ardhë asnjë kërkesë, kurse unë kam informatë se është një kërkesë por që nuk ka ardhë sot për shqyrtim.

Kryesuesi- siç jemi marrë vesh kërkesat fillimisht duhet të shkojnë në drejtorinë përkatëse për shqyrtim e pastaj të vinë në KPF, në vazhdim i qiti në votim heqjen nga rendi i ditës të pikave 3-Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë; dhe pika nr.4-Shqyrtimi i Planit të mobilitetit;. Njëzëri pikat nr 3 dhe 4 hiqen nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk jemi paisë me material për këto dy pika, pastaj e qiti në votim rendin e ditës pa pikat 3 dhe 4, i cili miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet procesverbali njëzëri pa vërejtje.

II.Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit Rinorë.

Yllarta Thaqi-thotë, si plan është i mirë dhe më ka pëlqyer, ndërsa sa u përket aktiviteteve të vitit 2023 nuk figurojnë fare edhe pse ato po mbahen.

Drejtoresha, Leonora Ukëhajdaraj- ka sqaruar se për vitin 2023 nuk figurojnë aktivitetet sepse një herë duhet të miratohet plani pastaj të themelohet KVRL e pastaj të shkojmë me zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

Vatan Istrefaj- deri sa nuk ekzistojnë strukturat e KVRL është mungesë e madhe dhe nuk është funksional Plani pa KVRL.

Faton Selmanaj- pyet, kurë do të themelohet KVRL.

Drejtoresha- përgjigjet se KVRL planifikohet të themelohet në shtator pasi që hapen edhe shkollat dhe është mundësia më e madhe e nxënësve për aktivitete.

Rekomandim: KPF pas shqyrtimit të kësaj pike njëzëri e përcjellin për shqyrtim në leximin e parë në Kuvend, pa ndryshime, mirëpo që të funksionalizohet ky plan kërkohet sa ma shpejt që të formohet KVRL.

III.Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.

VI.Shqyrtimi i Planit të mobilitetit;

Rekomandim: KPF i rekomandon Kuvendit heqjen e pikës nr.3 dhe nr.4 nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk janë paisë me material për këto dy pika.

V.Shqyrtimi i model rregullores për taksat komunale;

Yllarta Thaqi, kryesuese e komisionit për përpunimin dhe harmonizimin e tekstit të kësaj rregullore, ka sqaruar se rregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit si dhe janë inkorporuar në tekst të gjitha propozimet që kanë ardhë gjatë procedurës së shqyrtimit, kështu që si e tillë për mua kjo rregullore është ok, ka thënë ajo.

Rekomandim: KPF e shqyrtuan tekstin e model rregullores dhe pas sqarimeve të dhëna nga Kryetarja e Komisionit për hartimin e model rregullores, Yllarta Thaqi, e cila ka thënë se rregullorja i ka kaluar procedurat e shqyrtimit dhe janë bërë në tekst të gjitha ndryshimet e propozuara, model rregullorja njëzëri përcillet për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

VI.Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës,

Rekomandim: KPF e përcjellin për shqyrtim në kuvend raportin gjashtëmujor të punës së kryetarit pa debat.

VII.Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar;

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë, pastaj e ka hapë debatin rreth saj.

Florim Mataj- thotë se vazhdimisht kam kërkuar që të ulen të gjitha shpenzimet në përgjithësi dhe prap e kam atë kërkesë-uljen e shpenzimeve.

Faton Selmanaj-thotë, raporti dëshmon se keqmenaxhimi po vazhdon.

Drejtoresha, Dafina Cacaj- sqaron se raporti paraqet pasqyrën e saktë të shpenzimeve, nuk ka keqmenaxhim por keqklasifikim të shpenzimeve, dhe kjo na vjen edhe për shkak të shpenzmimit të buxhetit me përmbarues që buxhetin e marrin aty ku e gjejnë e jo sipas planifikimit.

Yllarta Thaqi- thotë se ka shumë shpenzim të buxhetit për kontrata për shërbime të veçanta ku shumë emra nuk po figurojnë fare dhe nuk po dihet për kënd po shkojnë ato mjete, pastaj ka shtruar pyetjen se çka furnizon Hajrije Selmanaj sepse shumë buxhet ka shku për te.

Drejtoresha, Dafina- përgjigjet se të gjitha organizimet që mbahen, gjithë materiali rreth organizimit siç janë fletushkat e materiale të tjera për informim të qytetarëve përgaditen aty.

Faton Selmanaj- kërkon sqarim te-Shpenzime të ndryshme, Fekri Qufaj(shpenzime intelektuale).

Drejtoresha Dafina- përgjigjet se në atë kod janë të gjitha pagesat e komisioneve të ndryshme, dhe unë do të vazhdoj të bëjë pagesat për mëditje të komisioneve të ndryshme deri në momentin kur do të marr vërejtje nga auditori.

Florim Mataj- thotë se unë e kam ngritë disa herë çështjen e shumë shpenzimeve të ndryshme, por nuk e kam marrë arsyeshmërinë për to asnjëherë, prandaj ka shtuar ai, se është mirë që të na bindni me arsyeshmërinë e shpenzimeve, nuk shkohet kështu sipërfaqësisht ka thënë ai me i arsyetu shpenzimet e ndryshme dhe për temat të cilat i ngritim këtu duhet të epët arsyeshmëria.

Drejtoresha, Dafina- përgjigjet se për çdo shpenzim është landa komplet por për shkak të volumit të madh të materialit nuk po kemi mundësi me i sjellë këtu komplet, por nëse ju kërkon për çdo shpenzim që ju e evidentoni unë jau sjelli landën.

Florim Mataj- ka thënë, për shembëll 100.000 euro shpenzime për dreka, aty kërkoj që të specifikohet si psh kurë pagesat bëhen për dreka të klubeve sportive të ceket si shpenzim për dreka të klubeve sportive.

Faton Selmanaj- kërkon sqarim, te pagesa e Mihane Dautaj B.I., e cila i ka marrë mjetet përmes procedurës së përmbarimit, për të cilën drejtoresha sqaron se janë shpronësimit.

Yllarta Thaqi- kërkon që sqarimet të epën në mënyrë ma bindëse.

Faton Selmanaj- kërkon që raportin me jau përcjellë edhe në formën excel, për të cilën drejtoresha thotë se do të jau përcjelli edhe excel.

Drejtori i drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj- ka sqaruar për shpenzimet të cilat janë bërë për aktivitetin Via Ferrata, i zhvilluar për disa ditë radhazi.

Vatan Istrefaj- thotë, mirë që është financu KF “Deçani” por është mirë që të financohet edhe KF “Irzniqi”, pastaj ka kërkuar sqarim për një pagesë në emër të Veton Binakaj.

Drejtoresha – ka sqaruar se KF “Irzniqi” është përfitues me thirrje publike por pagesa nuk është bërë ende, poashtu sqaron edhe për pagesën në emër të Veton Binakaj(për arsye se përfituesi nuk ka qenë në sistem dhe në këtë rast pagesa bëhet me marrëveshjen e palëve).

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar raportin gjashtëmujor të shpenzimeve, ku kanë kërkuar sqarime të ndryshme, për të cilat ka sqaruar drejtoresha e drejtorisë për buxhet dhe financa, Dafina Cacaj, pas debatit KPF e përcjellin njëzëri për shqyrtim në kuvend raportin.

VIII.Shqyrtimi i Projekt – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave;

Rekomandim: KPF e përcjellin për shqyrtim në kuvend pa debat dhe me vërejtjen se nuk ka ardhë në mbledhje drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, për të dhënë sqarime.

IX.Shqyrtimi i Draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025.

Rekomandim: KPF edhe këtë pike e përcjellin për kuvend për shqyrtim, me vlerësimin e kryesuesit të KPF-së se plani është përgatitë mjaft mire, atje do të debatohet rreth tij.

Drejtoresha e buxhetit, Dafina- ka kërkuar që debatet publike për projekt buxhetin të mbahen gjatë muajit gusht sepse vitin e kaluar nuk kemi marrë poena edhe pse i kemi mbajte 7 debate por nuk i kemi mbajte në gusht por në shtator, dhe debatet të mbahen në objekt të komunës edhe këtë vit, jo në lokalitete siç kemi planifikua sepse sivjet shumicën e projekteve i kemi projekte në vazhdim, nuk janë projekte të reja.

X.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e Adem Lushaj për ribotim të librit, kërkesë e cila është shqyrtuar me insistimin e drejtorit të drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Isuf Demhasaj, kërkesë e cila nuk ju ka shku anëtarëve të KPF-së ashtu siç kërkohet me material të mbledhjes dhe ashtu siç kanë marrë qëndrim se nuk do të shqyrtohet asnjë kërkesë e cila nuk ju shkon me material të mbledhjes, si dhe nuk shqyrtohet asnjë pikë e cila nuk është drejtori përkatës për të dhënë sqarime për pikën që shqyrtohet.

Në fund pas një debati bukur të gjatë, nga i cili dolën propozime të ndryshme, KPF vendosi që kërkesa të shtyhet për mbledhjen e muajit shtator, ku duhet të vjen me material të mbledhjes edhe materiali i kërkesës.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ